



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 79/2021 (JR)  
Datë 15.12.2021

Vendim nr. 17 (JR)  
Datë 25.04.2024

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datat 15.04.2024 dhe 25.04.2024, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 469, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, pika 5; nenet A, Ç, D, Dh dhe F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63 dhe 61, pika 1, shkronja “b”; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; ligji nr. 44/2016, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe, pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ardian Braho (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë<sup>1</sup> së subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;* (ii) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;* (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;* (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;* (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit raportin,<sup>2</sup> duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, Ardian E. Braho. Nga informacioni i përditësuar me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 18.08.2021 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 30.08.2021, DSIK-ja ka konfirmuar se nuk disponon informacion shtesë, për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme.

2.3. KLP-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.03.2018, nga ILDKPKI, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ardian Braho, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, përcillet raport i deklasifikuar plotësisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2019.

Përgjithshme, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho.

3. Komisioni kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes mbi të tria kriteret e rivlerësimit, me vendimin nr. 469, datë 01.11.2021, Komisioni vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

4. Vendimin nr. 469, datë 01.11.2021, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, Komisioni e bazoi në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet si më poshtë.
  - 4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *[...] subjekti nuk ka deklaruar saktë pasurinë dhe janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje të pasurisë. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme dhe rezultoi në mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e tyre, sikurse është specifikuar në pikat përkatëse ku janë analizuar pasuritë.*
  - 4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: *[...] subjekti i rivlerësimit Ardian Braho ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*
  - 4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *[...] sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se pavarësisht problematikave të konstatuara, në një vlerësim tërësor të këtij kriteri, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.*
5. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi nuk provoi bindshëm: (i) *burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive në disponim/pronësi të personit të lidhur, babait të subjektit, duke tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të tezes, pa arritur ta provojë këtë rrethanë;* (ii) *pamundësinë financiare me burime të ligjshme të subjektit dhe të familjes së tij për të justifikuar: (a) depozitën e shumës 20.000 euro, në datën 7.5.2007, si dhe blerjen e apartamentit në datën 16.8.2007; (b) shpenzimet dhe investimet, ndër vite, në pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo gjendje/depozita bankare, [...] duke u gjendur në parashikimet e pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në përputhje me pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

---

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2020, KLP i ka përcjellë Komisionit “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho”.

### III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit, Ardian Braho, ka ankimuar vendimin nr. 469, datë 01.11.2021, të Komisionit, duke e konsideruar atë të pabazuar në prova dhe në ligj, të marrë në vlerësim të gabuar të rrethanave faktike të vërtetuara gjatë procesit administrativ dhe në interpretim të gabuar të koncepteve ligjore. Në përfundim të ankimit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”): (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi i Komisionit është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit si në aspektin procedural, ashtu edhe sa i përket zgjidhjes së themelit të çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
7. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspektet procedurale dhe procesin e rregullt ligjor, kryesisht lidhen me “barrën e provës” dhe, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në sa vijon:
  - 7.1. Komisioni ka marrë vendimin për fakte, shkaqe apo rrethana për të cilat nuk ka kaluar paraprakisht barrë prove, duke i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”).
  - 7.2. Ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vendosur një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative.
  - 7.3. Konstatimi kryesor i njoftuar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, nga i cili rrjedhin të gjitha konkluzionet negative, mbi të cilat mbështetet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, është se “*subjekti nuk ka deklaruar gjendjen cash të disponuar nga babai*”, ndërkohë që përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016, nuk ka ekzistuar detyrimi për deklarimin e pasurive dhe të ardhurave të prindërve, të cilët nuk kanë gëzuar statusin e personit të lidhur dhe nuk kanë pasur detyrimin për deklarim, pavarësisht se kanë jetuar me subjektin e rivlerësimit. Sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), prindërit e subjektit deklarues nuk kanë pasur detyrimin për deklarim. Nga këto parashikime ligjore rezulton përtej çdo dyshimi se, në cilësinë e subjektit deklarues, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat e prindërve apo kursimet që ata mbanin, qëndrim i konsoliduar tashmë nga organet<sup>4</sup> e rivlerësimit.
  - 7.4. Komisioni, në hetimin dhe vendimmarrjen e tij për subjektin e rivlerësimit, ka vepruar në kushtet e paragjyqimit dhe ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në raport me qëndrimet e tij të mëparshme për subjektet e tjera të rivlerësimit, e për këto arsye, i kërkohet Kolegjit të konstatojë këto fakte dhe të gjykojë çështjen në seancë gjyqësore publike, me qëllim administrimin dhe vlerësimin e drejtë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

---

<sup>4</sup> Shih vendimet nr. 410, datë 30.06.2021, nr. 185, datë 23.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe vendimin (JR) nr. 18/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit N. K.

8. Lidhur me themelin e çështjes, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ngre këto pretendime:

*8.1. Për llogaritë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit*

**8.1.1.** Komisioni ka arritur në konkluzione të gabuara, pasi nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar sipas situatës faktike dhe ligjore, rrethanat e marrëdhënies së tezes me babain dhe familjen e subjektit të rivlerësimit, si dhe ka injoruar tërësisht përgjigjet dhe shpjegimet e tij ndaj pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit administrativ.

**8.1.2.** Në kundërshtim me faktet e provuara gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në përfundimin e gabuar se nuk është provuar burimi i ligjshëm i vlerave monetare të depozituara dhe disponuara në llogarinë bankare të babait dhe as prejardhja dhe destinacioni final i tyre. Mbi supozime të paverifikuara dhe hamendësime, Komisioni ka konkluduar se shumat e derdhura *cash* në këto llogari janë pasuri e luajtshme e familjes së subjektit të rivlerësimit, pa burime të ligjshme financiare dhe se subjekti i rivlerësimit ka tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të një personi të afërm të familjes.

**8.1.3.** Subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e fshehjes së pasurisë, pasi nuk ka pasur detyrimin të deklarojë llogaritë bankare të babait si person i lidhur, as ndër vite, në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, kur vlerat monetare tashmë nuk disponoheshin në llogari bankare, të cilat ishin mbyllur në vitet 2006 – 2007, apo fizikisht, gjendje *cash*. Në këto kushte, nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur si qëllim apo ka bërë përpjekje për të evituar verifikimin dhe përgjegjësitë, që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare për legjitimimin e këtyre pasurive.

**8.1.4.** Depozitimi në sistemin bankar i shumave të sjella *cash*, nga tezja e familjarë të saj, dhe mbajtja fizikisht në kohë nga babai, nuk tregon tentativë për të fshehur prejardhjen e tyre, sikundër vlerëson Komisioni, duke konkluduar gabim dhe në shtrembërim të rrethanave, se prejardhja e shumave *cash* ka të bëjë me pasuri në pronësi të familjes së subjektit të rivlerësimit.

**8.1.5.** Komisioni, në analizën e tij, dukshëm ka vlerësuar në interpretim të gabuar dhe në shtrembërim të rrethanave të pasqyruara në dokumentet bankare, lidhur me transfertat bankare nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim “ShBA”) dhe lëvizjet e llogarive bankare, kur konkludon se burimi i transfertave bankare dhe depozitave në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA dhe burimi i depozitave në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA janë të pavarura dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën.

**8.1.6.** Komisioni, dukshëm, dhe në shtrembërim të rrethanave, në vendim ka krijuar një situatë hipotetike, kur vlerëson se, nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, mbeten pa përgjigje një sërë rrethanash, që lidhen me sjelljen, destinacionin dhe kthimin e shumave monetare. Krijimi i një situatë të tillë tregon një përpjekje për të rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit dhe për ta vënë në vështirësi atë për fakte që janë përtej mundësive të tij për t’iu përgjigjur, për rrethana që kanë të bëjnë me marrëdhënien e babait dhe të tezes, dhe veprimet e kësaj të fundit.

**8.1.7.** Komisioni duhet të kishte marrë parasysh mundësinë e kursimit të tezes dhe të familjarëve të saj, për periudhën 23.05.1993 deri më 31.12.1998, qoftë edhe nëpërmjet ndonjë metode alternative për llogaritjeje. Referuar parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhej të

mbante parasysh pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit, për të siguruar dokumentacion ligjor e provues mbi të ardhurat e tezes dhe familjes së saj për këtë periudhë, si dhe mënyrën e kthimit të shumave monetare tezes.

*8.2. Për apartamentin në pronësi të babait, blerë në vitin 2007, si dhe depozitimin prej tij të shumës cash 20.000 euro, në datën 07.05.2007, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA*

**8.2.1.** Konkluzioni i Komisionit mbi burimin e ligjshëm të këtyre pasurive është i njëanshëm dhe i padrejtë, në kundërshtim me provat e administruara, si dhe në vlerësim e interpretim të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**8.2.2.** Konkludimet e Komisionit mbi burimin e ligjshëm të shumës 20.000 euro dhe mosdijësinë e subjektit të rivlerësimit për ekzistencën e kësaj shume, si dhe për kursimet *cash* ndër vite, janë të gabuara, alogjike, abuzive, të paargumentuara e të pambështetura në prova, ndonëse në kuadër të një hetimi administrativ, sërish, bindja dhe mendimi duhet të jenë të bazuara në prova, rrethana dhe të argumentuar.

**8.2.3.** Lidhur me deklarin e kursimeve *cash*, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, prindërit nuk kanë gëzuar statusin e personit të lidhur dhe as nuk kanë pasur detyrimin për deklarim, pavarësisht se kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare me subjektin e rivlerësimit, qëndrim i konsoliduar i Komisionit dhe i Kolegjit.

**8.2.4.** Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë dhe ligjor për punësimin e nënës në sektorin privat dhe të babait deri në vitin 2004, Komisioni, me të padrejtë, nuk ka konsideruar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare si burime të ligjshme të paktën të ardhurat e përfituara nga puna e babait në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK gjatë periudhës 2004 – 2007.

**8.2.5.** Kolegji duhet të vlerësojë në tërësi analizën e Komisionit, mbi burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, pasi konkludimet e tij nuk janë në përputhje me faktet dhe rrethanat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë shkak, vendimi i Komisioni për këtë pasuri duhet të ndryshohet në favor të konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

**8.2.6.** Depozita bankare në emër të babait, në shumën 20.000 euro, duke analizuar të ardhurat e ligjshme të pensioneve të prindërve, kontributin e subjektit të rivlerësimit nga pagat dhënë në familje, për periudhën kohore nga viti 2001 deri në momentin që këto kursime janë depozituar në llogarinë bankare të babait, në maj të vitit 2007, tregon se ai ka pasur mundësi për të krijuar këtë shumë, madje edhe pa përfshirë të ardhurat nga punësimi i prindërve në sektorin privat.

*8.3. Për pasurinë, automjet “Mercedes Benz”*

**8.3.1.** Mosmarrja në konsideratë e kursimeve *cash* që prindërit kishin mundësi t’i kursenin deri në fund të vitit 2010, ndërkohë që nuk kanë pasur detyrimin për deklarimin e tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, ka sjellë si rrjedhojë balancën negative për krijimin e kësaj pasurie.

**8.3.2.** Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizimin e mundësisë financiare të burimeve të ligjshme në momentin e krijimit të pasurisë, në rastet kur disa anëtarë janë subjekte deklaruese dhe disa anëtarë jo, krijon konfuzion dhe pasaktësi. Komisioni duhet të përfshinte të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën janar – korrik 2011 dhe, ndërkohë, analiza për mundësinë e kursimit të

prindërve të bëhej e ndarë në disa periudha, për faktin se nuk mund të zerohet mundësia e kursimit, për sa kohë që ata nuk kanë qenë subjekte deklaruese.

**8.3.3.** Mjaftonte që Komisioni të përfshinte në analizën financiare pakësimin me 500.000 lekë të kursimeve *cash* të prindërve (shumë kjo që përfaqëson dhe vlerën e pensioneve të tyre në një vit), për të rezultuar me mundësi financiare për të përballuar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit. Për më tepër që analiza financiare e vitit 2010 ka rezultuar me balancë pozitive në vlerën 1.129.438 lekë.

**8.3.4.** Kolegji duhet të vlerësojë në tërësi analizën e Komisionit, e cila nuk është në përputhje me faktet dhe rrethanat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë arsye, vendimi i Komisionit për këtë pasuri duhet të ndryshohet në favor të konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton e provuar se mbulon me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti.

*8.4. Për depozitën në vlerën 12.980 euro, në emër të babait, çelur në datën 30.07.2014, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA*

**8.4.1.** Nëse në analizën financiare do të ishin përfshirë kursimet *cash* të akumuluar në vitet 2010-2011 nga prindërit, që përdorshin herë pas here për nevojat familjare, mundësia për krijimin e kësaj depozite do të rezultonte pozitive.

**8.4.2.** Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se, me prapësimet<sup>5</sup> mbi rezultatet e hetimit administrativ, i ka kërkuar Komisionit korrektimin e shpenzimeve jetike për djalin në vitet 2011 dhe 2012, për shkak të moshës së tij, si dhe përllogaritjen e shpenzimeve jetike në vitin 2013, për vajzën, në masën sa 1/3 e shpenzimeve jetike për person, pasi në pagesën e shkollës përfshiheshin dhe dy vakte.

**8.4.3.** Kolegji duhet të vlerësojë se analiza financiare dhe konkludimet e Komisionit mbi burimet e ligjshme, për krijimin e depozitës 12.980 euro, janë në interpretim të gabuar të rrethanave dhe fakteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë shkak, vendimi i Komisionit për këtë pasuri duhet të ndryshohet në favor të konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton e provuar se babai mbulon me burime të ligjshme financiare krijimin e kësaj pasurie.

*8.5. Mbi gjendjen cash në banesë, në shumën 1.300.000 lekë, në vitin 2015*

**8.5.1.** Nëse në analizën financiare për vitin 2015, shpenzimet jetike për vajzën do të përllogariteshin sa 1/3 e shpenzimeve jetike për person, pasi dy vakte i kalon në shkollë, atëherë korigjimi në uljen e shpenzimeve jetike për këtë vit, në shumën 94.016 lekë, do të prodhonte një rezultat për vitin 2015, në shumën (-) 230.379 lekë.

**8.5.2.** Kolegji duhet të vlerësojë se analiza financiare dhe konkluzionet e Komisionit mbi burimet e ligjshme të krijimit të shumës 1.300.000 lekë janë pasojë e një interpretimi të gabuar të rrethanave dhe fakteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë shkak, vendimi i Komisionit për këtë pasuri duhet të ndryshohet në favor të konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton e provuar se mbulon me burime të ligjshme financiare krijimin e kësaj shume.

---

<sup>5</sup> “Prapësime të prokurorit Ardian Braho, për të vërtetuar të kundërtën në përgjigje të barrës së provës”, në vijim “Prapësime mbi rezultatet e hetimit administrativ”.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 469, datë 01.11.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Ardian Braho, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore, të zhvilluar në dhomë këshillimi, në datat 15.04.2024 dhe 25.04.2024.
12. Në fillim të seancës gjyqësore të datës 15.04.2024, në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Në vijim, trupi gjykues analizon shkaqet që lidhen me procesin e rregullt ligjor, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim.
13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është marrë për fakte, shkaqe apo rrethana, për të cilat nuk i kishte kaluar paraprakisht barra e provës, duke i cenuar të drejtën e njohur nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016. Në këtë proces, Komisioni ka detyrimin ligjor t'i kalojë subjektit të rivlerësimit barrën e provës për çdo gjetje që, në vlerësim të tij, përbën mospërbushje detyrimi ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe ka si sanksion, marrjen e një masë disiplinore, pra një dënim administrativ. Me fjalë të tjera, Komisioni ose Kolegji duhet ta "akuzojnë" subjektin e rivlerësimit përpara se ta "dënojnë". Përbushja e këtij detyrimi ligjor lidhet me të drejtën që ka subjekti i rivlerësimit që të dëgjohet dhe të mbrohet në mënyrë efektive. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën



shkelje të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNj-së, për shkak të mosrespektimit të procesit të rregullt ligjor.

**13.1.** Trupi gjykues konstaton se argumentin e tij, subjekti i rivlerësimit e mbështet në dispozita kushtetuese dhe ligjore, konkretisht në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, të cilat i njohin Komisionit dhe Kolegjit, kompetencën për të hetuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Kjo kompetencë funksionale, sipas subjektit të rivlerësimit, limitohet deri në kufirin kur provat arrijnë nivelin e provueshmërisë, dhe, në këtë moment procedural, neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e detyron Komisionin/Kolegjin t'i kalojë subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj që Komisioni çmon se provojnë provat e mbledhura prej tij. Në këndvështrim të subjektit të rivlerësimit, kur Komisioni konstaton apo krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të caktuar, nëse ky element konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra apo të ndonjë mase tjetër, duhet t'ia bëjë me dije këtë mangësi apo situatë subjektit të rivlerësimit për t'i mundësuar atij të drejtën që ia njeh Kushtetuta, për të provuar të kundërtën.

**13.2.** Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt, pikërisht në garantim të së drejtës për të paraqitur prova dhe argumente për t'u dëgjuar drejtësisht e për t'u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj këtyre gjetjeve/akuzave që prezumojnë shkarkimin e tij nga detyra në zbatim të nenit D, F apo E, pika 5, dhe të nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Këtë argument, sipas subjektit të rivlerësimit, e mbështet dhe parashikimi i nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili referon në nenin 87, pika 1 dhe pika 2, shkronja "ç" e ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", që parashikon se njoftimi i palës dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar, duhet të bëjë prezent provat e administruara, rezultatet e hetimit, rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës. Në zbatim të këtij rregulli, Komisioni apo Kolegji, para se t'i japë subjektit të rivlerësimit mundësinë të dëgjohej, duhet t'i bëjë prezent përveç rezultateve të hetimit, edhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative, pra situatën e gjetjeve që mund të shkaktojnë marrjen e masës disiplinore, ose e thënë ndryshe, t'i kalojë barrën e provës, për t'i dhënë mundësinë të provojë të kundërtën. Vetëm nëse subjekti i rivlerësimit nuk paraqet prova, argumente apo nuk reagon për të realizuar detyrimin e tij që lidhet me provueshmërinë, siç parashikojnë nenet 84 e 85 të Kodit të Procedurave Administrative<sup>6</sup>, organi administrativ, sipas subjektit të rivlerësimit, ka të drejtë që, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë duke u mbështetur në provat e mbledhura deri në atë moment, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tij të brendshme.

**13.3.** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka bërë të zbatueshëm nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, ku përveç mungesës së burimeve të ligjshme

---

<sup>6</sup> Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 84, parashikon: "Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të këtij Kodi", dhe neni 85 parashikon: "1. Në qoftë se palët nuk i përgjigjen njoftimit, administrata mund të bëjë një njoftim të ri ose të ndërpresë procedurën, kur një gjë e tillë nuk cenon ndonjë interes publik. 2. Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes, por në asnjë rast kjo nuk e çliron organin publik nga detyrimi për t'i kërkuar vetë provat dhe faktet dhe për të dhënë një vendim përfundimtar. 3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë".

financiare për krijimin e pasurisë, ka konstatuar edhe elemente, që në vlerësim të tij mund të ngrenë dyshime për fshehje të pasurisë, duke aplikuar ndaj subjektit të rivlerësimit edhe nenin 33, pika 5, shkronja “c” e këtij ligji. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, dyshimet për fshehje lidhen me vlerat monetare në USD, që babai i subjektit të rivlerësimit ka derdhur *cash* në llogaritë e tij bankare, shuma që pretendohen të jenë sjellë nga tezja e subjektit të rivlerësimit dhe familjarët e saj nga ShBA-ja, të cilat do të trajtohen në mënyrë të shtjelluar në nënparagrafët e paragrafit 23 në këtë vendim. Pretendimin se Komisioni nuk i ka kaluar paraprakisht barrë prove, subjekti i rivlerësimit ia adreson pikërisht arsyetimit dhe konkluzionit të Komisionit, i cili për këto shuma ka krijuar bindjen se *“janë pasuri e luajtshme e familjes së subjektit të rivlerësimit, pa burime të ligjshme financiare dhe, për këtë shkak, subjekti ka tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të tezes, pa arritur ta provojë këtë rrethanë”*. Ky konkluzion, që sipas subjektit të rivlerësimit përbën shkakun kryesor të marrjes së masës disiplinore ndaj tij, është pasqyruar për herë të parë vetëm në vendimin e zbardhur, duke i mohuar në këtë mënyrë subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive, në kundërshtim flagrant me rregullat e procesit të rregullt ligjor.

**13.4.** Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues verifikoi raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ, dërguar subjektit të rivlerësimit, më datë 05.10.2021, nëpërmjet të cilit Komisioni, bazuar në parashikimet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi konstatimet se: *“Ngrihen dyshime mbi destinacionin dhe kthimin e vlerave monetare tezes së subjektit, në total në shumën 78.561 USD; -- Duket se tezja dhe familjarë të saj kanë pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 24.875 USD, për shumat e dërguara në Shqipëri”*. Në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni duhet të ishte shprehur qartë dhe në mënyrë eksplicite në rezultatet e hetimit administrativ, mbi dyshimin se i konsideronte pasuri të familjes së subjektit të rivlerësimit, shumat në USD, të depozituara *cash* nga babai, në llogaritë e veta bankare. Megjithatë, nga natyra e verifikimeve të kryera nga Komisioni në kuadër të këtij procesi, të përmendura në rezultatet e hetimit administrativ, si verifikimi i mundësisë financiare të tezes dhe familjes së saj për të krijuar vlerat monetare, pikëpyetjet e ngritura me pyetësorët mbi destinacionin dhe investimet e mundshme të tyre në Shqipëri, mënyrën e sjelljes së këtyre shumave dhe kthimit të tyre përsëri në ShBA, si dhe informacioni i gjeneruar nga sistemi TIMS mbi hyrje-daljet në Republikën e Shqipërisë të tezes së subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj, apo verifikimi mbi investime të mundshme të tyre, tregojnë qartazi qëllimin e Komisionit për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të prejardhjes dhe përkatësisë së këtyre vlerave monetare.

**13.5.** Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 25.10.2021, trupi gjykues konstaton se pyetjet e ngritura nga kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar ishin orientuar kryesisht në drejtim të dyshimeve lidhur me shumat në USD të sjella fizikisht, administrimin e këtyre shumave nga babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe kthimin e tyre në ShBA. Kryesuesja gjatë seancës dëgjimore, rezulton t’i jetë drejtuar subjektit të rivlerësimit, duke u shprehur: *“a nuk do t’i shikoje [...], këto si para të fshehura po i quaj në thonjëza, në emër të tezes, në një kohë që mund të jenë tuajat, sepse nuk shikoj gjurmë, përveç faktit që tezja ka para [...]”*, e duke i kërkuar informacion sqarues mbi rrethana të tilla, që lidheshin me mënyrën e mbërritjes së këtyre shumave në Shqipëri, arsyen e sjelljes së tyre, shkakun e dështimit të idesë së përdorimit të shumave në vend, arsyen pse ngarkoi babain e subjektit të rivlerësimit me administrimin e tyre, si dhe kohën dhe mënyrën e kthimit. Nga pyetjet e ngritura, në vlerësim të trupit gjykues, është lehtësisht e kuptueshme

se dyshimi i Komisionit qëndronte pikërisht në faktin që nuk provohej se shumat, kryesisht ato në *cash*, t'i përkisnin tezes së subjektit apo familjarëve të saj, pasi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to, nuk mbështeteshin në dokumentacion provues. Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se dyshimi për pasuri të fshehur është ngritur qartë gjatë seancës dëgjimore, por është insinuar edhe në rezultatet e hetimit administrativ dhe nuk përmendet për herë të parë në vendimin e arsyetuar, ashtu siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

**13.6.** Ndonëse, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të argumenteve, përmend qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën<sup>7</sup> e tij, sa i përket pretendimeve të ngritura për cenim të standardit për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të moskalimit të barrës së provës, trupi gjykues konstaton se qëndrimi i Kolegjit, në këto raste, i përgjigjet situatave të ndryshme faktike nga ajo e subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, mosparaqitja e dyshimit për fshehje pasurie në rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni, sa u takon shumave në USD, në llogaritë e babait të subjektit të rivlerësimit, sikurse arsyetuar më sipër në këtë vendim, nuk duhet perceptuar në drejtim të ndonjë shkeljeje procedurale apo mohimit të subjektit të rivlerësimit për të ushtruar të drejtën e një mbrojtjeje efektive, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor, aq më tepër kur, referuar ankimit dhe parashkrimeve me shkrim të depozituara në Kolegj, përveçse shpjegimeve të dhëna dhe pretendimit se, për shkak të periudhës së gjatë kohore, ndodhet në pamundësi objektive, sipas parashkrimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me të ardhurat e familjes së tezes, destinacionin dhe kthimin e shumave, që mund të ishin paraqitur si të tilla edhe pas rezultateve të hetimit apo në seancë dëgjimore, nëse do të kishte qartësi për këtë gjetje, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur argumente përmbajtësore shtesë të mbështetura në prova të reja, që paraqesin nevojën për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet debatit gjyqësor.

**14.** Subjekti i rivlerësimit në ankim, sa i përket shumave monetare të depozituara në bankë, thekson se babai, tezja dhe familjarët e saj nuk gëzonin statusin e personit të lidhur apo tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Situata e paraqitur nga Komisioni në raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ përbën një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale dhe jo objektive, në kundërshtim me parashkrimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Për ekzistencën e këtyre shumave, subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore mbi një situatë të paparashikuar ligjore, të pabazuar në ligjin nr. 84/2016, përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar.

**14.1.** Trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë pretendim, me arsyetimin se, ndonëse në lidhje me vlerat monetare të depozituara në llogarinë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit, gjatë periudhës 2003 – 2005, ky i fundit dhe tezja nuk gëzonin statusin e personit të lidhur apo tjetër të lidhur, cilësime këto të dhëna vetëm me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në zbatim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasuri të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit në emër të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të tij, ka të drejtën të analizojë dhe të evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me këto pasuri, përfshirë dhe likuiditetet *cash* apo në llogari bankare, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime se këto pasuri mund t'i përkasin subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

---

<sup>7</sup> Shih vendimin (JR) nr. 11, datë 03.07.2020, paragrafi 28, vendimin (JR) nr. 35, datë 15.12.2020, paragrafi 46, vendimin (JR) nr. 28, datë 27.09.2021, paragrafi 29.10, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

14.2. Në situatën faktike të konstatuar nga Komisioni, në të cilën babai i subjektit të rivlerësimit kryente veprime financiare në llogaritë bankare në emër të tij, duke depozituar, tërhequr e ridepozituar shuma të konsiderueshme në USD, për të cilat Komisioni u vu në dijeni gjatë hetimit administrativ kryesisht, nuk e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar, pasi në atë periudhë subjekti i rivlerësimit ishte duke ushtruar detyrën e tij si prokuror, duke qenë njëkohësisht subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, në të njëjtën përbërje familjare dhe ekonomi të përbashkët me babain e tij. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, pyetjet e ngritura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore nuk tregojnë përpjekje të Komisionit për të rënduar pozitën dhe vënë në vështirësi subjektin e rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi, por për të qartësuar situatën faktike të bërë prezente gjatë hetimit administrativ. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka kaluar një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale dhe jo objektive, është i pabazuar.

15. Po në kuadër të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, mund të vendoset barrë prove vetëm në dy rastet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës në pikat 4 dhe 5 të tij. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, as në rezultatet e hetimit administrativ dhe as në vendim, Komisioni nuk ka konkluduar pasuri më të madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, dhe në asnjë rast nuk është arritur në përfundimin se pasaktësitë në deklarin e pasurisë kanë qenë me qëllim fshehje pasurie, e për pasojë, nuk kishte arsye të vendoste barrë prove.

15.1. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se parashikimet kushtetuese të sjella në vëmendje prej tij nuk pengojnë kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në rastet kur nga hetimi administrativ, është konkluduar se provat kanë nivelin e provueshmërisë lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme apo me paqartësitë e tjera të konstatuara në kuadër të këtij hetimi. Barra e provës nuk kalohet vetëm në ato raste kur dispozita kushtetuese shprehet në mënyrë eksplicite mbi prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe detyrimit e subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën, por në çdo rast kur konstatimet e Komisionit mund të bëjnë të zbatueshëm një shkak shkarkimi nga detyra, siç mund të jetë neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë, si pasojë e gjetjes së subjektit të rivlerësimit në një apo disa nga kushtet e parashikuara nga ky ligj, përkatësisht në nenin 33, pika 5, shkronjat “b”, “c”, “ç” apo “d” të tij. Interpretimi mbi zbatueshmërinë e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, gjendet i trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit.

16. Në vijim, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se Komisioni, pavarësisht konkluzioneve të ndryshme për çdo pasuri, me rezultatet e hetimit paraprak në përmbledhje të të gjithë konstatimeve, duhet të njoftojë qartë shkeljen që mendon se është kryer nga subjekti i rivlerësimit, dhe përcaktimin e bazës ligjore, paragrafin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 (*si për shembull, më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme 61/1, deklarin të pamjaftueshëm 61/3, ose cenim të besimit të publikut 61/5 etj.*).

16.1. Përgjigjen ndaj këtij pretendimi, Kolegji e ka shtjelluar në qëndrimin e mbajtur tanimë në jurisprudencën<sup>8</sup> e tij, duke vënë theksin te fakti se qëllimi i hetimit administrativ nuk është të njoftojë apo t'i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara mund të çojnë drejt prezumimit

---

<sup>8</sup> Shih vendimin (JR) nr. 3, datë 06.02.2023, paragrafi 12.14, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit T. H.

të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por se provat e grumbulluara kanë arritur mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit në përfundim të fazës së hetimit administrativ. Interpretimi *a contrario*, se Komisioni duhet të kishte përcaktuar që me rezultatet e hetimit, referencën apo pasojën ligjore, në vlerësim të trupit gjykues do të përbënte paragjykim të çështjes, në një fazë kur nuk ishin administruar ende prapësimet e subjektit të rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, nuk ishte zhvilluar seanca dëgjimore, gjë që do të vinte në kundërshtim me nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon vendimmarrjen vetëm pas zhvillimit të kësaj seance. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

16.2. Mbështetur në arsyetimin më sipër në këtë vendim, trupi gjykues nuk konstaton që Komisioni të ketë kaluar një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive, apo të ketë abuzuar me të, por në funksion të këtij procesi ka vepruar në gjuhën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore.

17. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimi kryesor i njoftuar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, nga i cili rrjedhin të gjitha konkluzionet negative mbi të cilat mbështetet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, është se “*subjekti nuk ka deklaruar gjendjen cash të disponuar nga babai*”, ndërkohë që përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016, nuk ka ekzistuar detyrimi për deklarimin e pasurive dhe të ardhurave të prindërve, të cilët nuk kanë gëzuar statusin e personit të lidhur dhe nuk kanë pasur detyrimin për deklarim, pavarësisht se kanë jetuar me subjektin e rivlerësimit. Sipas ligjit nr. 9049/2003, prindërit e subjektit deklarues nuk kanë pasur detyrimin për deklarim. Nga parashikimet ligjore rezulton përtej çdo dyshimi se, në cilësinë e subjektit deklarues, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat e prindërve apo kursimet që ata mbanin, qëndrim i konsoliduar tashmë nga organet<sup>9</sup> e rivlerësimit.

17.1. Në analizë të këtij shkakut ankimor, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ trupi gjykues konstatoi se, sipas certifikatës të përbërjes familjare të lëshuar nga gjendja civile, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjithmonë në të njëjtën përbërje familjare me prindërit e tij. Për pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, si ato në emër të subjektit të rivlerësimit dhe ato në emër të babait të tij, si burim krijimi deklarohen të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes. Gjatë hetimit administrativ në Komision, por dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se si burim për krijimin e pasurive, konkretisht, depozitës 20.000 euro në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, në vitin 2007, në emër të babait, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit po në këtë vit, automjetin “Mercedes Benz”, në vitin 2011, në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe depozitën në vlerën 12.980 euro, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, në vitin 2014, po në emër të babait, kanë shërbyer edhe kursimet *cash* të prindërve, të krijuara në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarim.

17.2. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit, përbërjen familjare e ka deklaruar së bashku me prindërit ndër vite, ndërsa të ardhurat e tyre i deklaroi - në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në deklaratën periodike vjetore 2016, dorëzuar pas kësaj të fundit. Sa u përket kursimeve në *cash*, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar këtë lloj pasurie në deklaratat periodike vjetore 2011 – 2015. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursime në shumën

---

<sup>9</sup> Shih vendimet nr. 410, datë 30.06.2021 dhe nr. 185, datë 23.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendimin (JR) nr. 18/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit N. K.

300.000 lekë, me burim nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, për periudhën 01.10.2011 deri më datë 01.03.2012, ndërsa në deklaratat periodike vjetore 2012, 2013, 2014 dhe 2015, kursimet deklarohen me burim krijimi pagat e subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortes, si dhe pensionet e prindërve të tij.

17.3. Pavarësisht se ligji nr. 9049/2003, në nenin 21 të tij, ka përcaktuar detyrimin për deklarimin e pasurisë, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit deklarues dhe të familjes së tij, konkretisht bashkëshortit/es e fëmijëve në moshë madhore, dhe nuk ka përcaktuar detyrimin për deklarim për prindërit e subjektit deklarues, në kushtet kur si kontribut për krijimin e kursimeve *cash* të babait, kanë shërbyer dhe të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, në logjikën e këtij ligji, ky i fundit ka pasur detyrimin të deklarojë pjesën e *cash*-it të kursyer nga kontributi i tij, ose të deklaronte pjesën takuese përpjesëtimore me numrin e anëtarëve të familjes të kursimeve *cash* të familjes (1/3 e kursimeve *cash*).

17.4. Ndonëse në parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, të depozituara në Kolegj, në zbatim të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit përmend qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në dy vendime<sup>10</sup> të tij, për mosdeklarimin e kursimeve *cash* të prindërve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se rastet e përmendura paraqesin një situatë të ndryshme faktike krahasuar me atë objekt shqyrtimi. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka përmbushur një detyrim të tillë në deklaratat periodike vjetore dhe është në pamundësi për të saktësuar kontributin e tij në kursimet *cash* të pretenduara, në vijim të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin e tij nr. 18, datë 26.07.2019, paragrafi 24.2<sup>11</sup>, sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si dhe konfuzionit të subjekteve deklaruese lidhur me deklarimin e të ardhurave dhe pasurive në emër të prindërve në kuadër të një interesi pasuror, Kolegji, duke mbajtur një qëndrim garantist, kontrollon analizën financiare të Komisionit me këtë arsye, për të provuar mundësinë financiare kumulative të babait të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kryefamiljarit, për krijimin e depozitës bankare në shumën 20.000 euro dhe apartamentit të blerë në vitin 2007, meqë në deklaratën periodike të vitit 2011 e në vijim është deklaruar gjendja e kursimeve *cash* të familjes B.

18. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në kushtet e paragjyqimit, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm në raport me subjekte të tjera të rivlerësimit, e për këto arsye, Kolegji duhet të gjykojë çështjen në seancë gjyqësore publike, me qëllim vlerësimin e drejtë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të konstatuara gjatë hetimit administrativ, gjendet i pabazuar nga trupi gjykues, pasi pretendime të tilla nuk përbëjnë shkak *apriori* për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të çështjes në shqyrtim dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike.
19. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, riçeljen dhe përsëritjen e hetimit gjyqësor me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara bashkëlidhur ankimit, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, si dhe kryerjes së një analize të drejtë financiare.

<sup>10</sup> Shih vendimin (JR) nr. 20, datë 03.05.2023, paragrafët 11.4 deri 11.11, dhe vendimin nr. 26, datë 03.07.2023, paragrafi 14.10, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

<sup>11</sup> Vendimi (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, paragrafi 24.2, citon: “[...] Subjekti i rivlerësimit, [...], ka pasur për detyrë të deklaronte likuiditetet në çfarëdo forme, por nuk mund të deklaronte ato likuiditete që ishin në administrim të prindërve dhe të familjes së saj, pavarësisht nga fakti se familja mund të kishte krijuar kursime edhe për shkak të kontributit të saj me të ardhurat nga paga [...]”.

19.1. Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto akte shkresore: (i) “vërtetim” të znj. Z. A., të datës 14.10.2021, përpara noterit publik A. O., në New Jersey; (ii) dokument, lëshuar nga PNC Bank, më datë 05.10.2021, në të cilin citohet: “Çeqet, mandatet e depozitimeve dhe lëvizjet e llogarive bankare, mbahen për shtatë vjet. Kërkesa për të dhëna përtej afatit 7-vjeçar nuk mund të përmbushet”<sup>12</sup>. Trupi gjykues konstaton se vërtetimi i datës 14.10.2021 ka të njëjtën përmbajtje me atë të datës 10.10.2021, lëshuar po nga tezja e subjektit të rivlerësimit, depozituar gjatë seancës dëgjimore të datës 25.10.2021. Gjithashtu, gjatë kësaj seance dëgjimore rezultoi e administruar edhe kopje e dokumentit të lëshuar nga PNC Bank në ShBA. Në këto kushte, aktet bashkëlidhur ankimit, nuk mund të konsiderohen prova të reja në këtë proces, për t’iu nënshtruar më pas, përcaktimeve që normojnë pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>13</sup>.

19.2. Ndërsa sa i përket vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2024, “Për pagesën e shkollës për A. A. B., për periudhën 2012 – 2016”, lëshuar nga shkolla anglo-shqiptare “{\*\*\*}”, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet me shkrim, Kolegji, pavarësisht se dispozita ligjore, neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nuk parashikon paraqitjen e provave të reja, e ka vlerësuar këtë akt shkresor nën parashikimet e nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, duke e konsideruar të panevojshëm dhe të parëndësishëm për zgjidhjen në themel të çështjes. Për pasojë, trupi gjykues vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor, me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara me ankimin dhe parashtrimet.

20. Në përmbyllje të sa më sipër, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji e gjeti të pambështetur në fakte dhe në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe për marrjen e provave të reja. Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit mbi këtë kriter**

### *Për llogaritë bankare në USD të babait të subjektit të rivlerësimit*

21. Për shumat monetare në monedhën USD, të derdhura *cash* nga babai i subjektit të rivlerësimit, në llogaritë e veta bankare, Komisioni krijoi bindjen se ato janë pasuri e luajtshme e familjes së subjektit të rivlerësimit, pa burime të ligjshme financiare dhe, për këtë shkak, subjekti i rivlerësimit ka tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke pretenduar se ato nuk ishin shuma monetare të familjes së tij, por të tezes, pa arritur ta provojë këtë rrethanë.

Komisioni, në vendim çmoi se problematika e konstatuar në këtë pikë, lidhur me pamundësinë e mjeteve monetare të ligjshme për depozitat e krijuara me derdhje të shumave të konsiderueshme *cash* nga babai i subjektit, në një periudhë kur subjekti ushtronte detyrën si prokuror, e konsideruar së bashku me problematikat e tjera të kriterit të pasurisë, rezultoi e mjaftueshme për aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pa qenë nevoja e analizës së mundësive financiare të tezes së

<sup>12</sup> Në gjuhën origjinale: “Check images, deposit tickets and statements are retained for seven years. Image requests for items older than seven years can’t be fulfilled”.

<sup>13</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

subjektit për të disponuar me burime të ligjshme shuma të transferuara nëpërmjet sistemit bankar, në llogaritë bankare të babait të subjektit. Përpos paqartësive mbi shkaqet e transferimit, burimit të ligjshëm të këtyre shumave, mungesës së provës mbi faktin se ato janë marrë mbrapsht nga tezja, si dhe mbi mënyrën dhe kohën e (ri) transferimit të tyre në ShBA, Komisioni çmon se në çdo rast, edhe nëse do të provohej pretendimi i subjektit për këtë pjesë, kjo nuk do ta ndryshonte vlerësimin përfundimtar dhe vendimmarrjen e tij.

22. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, se shumata e derdhura *cash* në këto llogari janë pasuri e luajtshme e familjes së subjektit të rivlerësimit, pa burime të ligjshme financiare dhe se subjekti i rivlerësimit ka tentuar të evitojë verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare, duke i konsideruar ato të gabuara dhe të mbështetura në supozime të paverifikuara, mbi hamendësime dhe interpretim të gabuar të rrethanave të provuara ndryshe nga hetimi administrativ. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzione të gabuara, pasi nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar sipas situatës faktike dhe ligjore rrethanat e kësaj marrëdhënieje, ka injoruar tërësisht përgjigjet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ndaj pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit administrativ, dhe pa argumente logjike i ka vlerësuar ato jobindëse, kontradiktore, pa arsye logjike e ekonomike të besueshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ndodhet në kushtet e fshehjes së pasurisë, pasi nuk ka pasur detyrimin të deklarojë llogaritë bankare të babait, si person i lidhur, as ndër vite, në deklaratat periodike vjetore, dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, kur vlerat monetare tashmë nuk disponoheshin në llogaritë bankare, të cilat ishin mbyllur në vitet 2006 – 2007, apo fizikisht/gjendje *cash*.

23. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni, për trupin gjykues, situata faktike paraqitet si vijon:

23.1. Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e rivlerësimit, në zbatim të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i është drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve të tjera financiare, me kërkesën për informacion mbi çdo veprimtari bankare dhe financiare të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes dhe prindërve të tyre. Nga përgjigjet e administruara dhe analizimi i tyre, Komisioni konstatoi se babai i subjektit të rivlerësimit, z. E. B., ka pasur llogari bankare, depozitë në monedhën USD, në “Bankën Italo-Shqiptare” ShA (sot “Intesa Sanpaolo Bank” ShA), si dhe në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, më konkretisht:

23.1.1. Në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA<sup>14</sup>, z. E. B. ka pasur llogari bankare me numër {\*\*\*}, depozitë në USD, me numër {\*\*\*}, si dhe llogarinë rrjedhëse me numër {\*\*\*}, po në monedhën USD. Kjo e fundit, llogaria rrjedhëse rezulton të jetë kredituar nëpërmjet gjashtë transferimeve bankare<sup>15</sup>, në vlerën totale 46.561 USD, si dhe tri depozitime *cash*: (i) 2.000 USD, në datën 15.04.2003; (ii) 16.240 USD, më datë 03.02.2004, dhe (iii) 30.000 USD, më datë 09.09.2005. Transaksioni i fundit në këtë llogari është kryer më datë 03.11.2006, me tërheqjen e shumës 2.212 USD.

23.1.2. Në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA<sup>16</sup>, z. E. B. ka pasur depozitën në USD, çelur më datë 01.04.2004 dhe mbyllur më datë 29.01.2007, në të cilën rezulton të ketë depozituar *cash* shumata: (i)

<sup>14</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.10.2019.

<sup>15</sup> Transferime bankare me përshkrimin “Incoming TRF Paid”: (i) më datë 07.05.2003, shuma 9.985 USD; (ii) më datë 30.09.2003, shuma 9.335 USD; (iii) më datë 23.09.2004, shuma 19.970 USD; (iv) më datë 01.11.2004, shuma 4.990 USD; (v) më datë 02.11.2004, shuma 790 USD dhe (vi) më datë 23.12.2004, shuma 1.490 USD.

<sup>16</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2019.



16.252 USD, më datë 13.05.2004, prej së cilës tërheq 2.000 USD, më datë 14.06.2004, ndërsa pjesën tjetër, prej 14.260 USD, e investon në depozitë njëmujore, të rinovueshme, dhe (ii) 25.000 USD i ka derdhur në të, më datë 14.04.2005. Nga depozita 39.149 USD, e krijuar me këto dy shuma, z. E. B. tërheq 20.000 USD, më datë 25.05.2006, dhe shumën 19.515 USD, më datë 29.01.2007.

**23.2.** Në kushtet kur fondet në USD, të transferuara në llogarinë bankare të z. E. B., pranë “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, nuk ishin deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2003 dhe 2004 apo në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit të datës 27.04.2021, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë me dokumentacion justifikues, burimin e krijimit të tyre dhe marrëdhënien me dërguesin, ndërsa për depozitimet *cash*, në dy bankat e nivelit të dytë, të sipërcituara, Komisioni, përveç dokumentacionit për justifikimin e burimit të tyre, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë edhe destinacionin e këtyre shumave.

**23.2.1.** Në përgjigjen e tij, të datës 07.05.2021, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka qenë në dijeni lidhur me ekzistencën e këtyre fondeve të dërguara nga jashtë Shqipërisë dhe ka ardhur në dijeni të tyre, vetëm nëpërmjet pyetësorit të Komisionit. Nga komunikimi me babain mbi këtë çështje, është informuar se këto fonde janë dërguar nga shtetasit amerikanë, Z. dhe Z. A., tezja dhe bashkëshorti i saj, dikur banorë të qytetit të Bilishtit, të larguar nga Shqipëria në vitin 1989, në drejtim të Greqisë, dhe në vitin 1993 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aktualisht rezidentë në shtetin e New Jersey-t.

**23.2.2.** Në vijim të përgjigjes, subjekti i rivlerësimit sqaron se, për shkak të moshës së babait, gjendjes shëndetësore të tij dhe kohës së gjatë nga transferimi i fondeve, nga komunikimi me të, nuk ka arritur të sigurojë të dhëna të konsiderueshme lidhur me destinacionin e këtyre fondeve, por vetëm që ai e ka çelur llogarinë bankare në vitin 2003 me kërkesën e tezes dhe të bashkëshortit të saj, me qëllim transferimin e këtyre vlerave monetare, të cilat do të tërhiqeshin sipas kërkesës së tyre, dhe për të cilat babai kishte vetëm rolin e pritësit. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje lidhjen e ngushtë që ka ekzistuar mes prindërve të tij dhe tezes, e cila për shkak dhe të disa problemeve familjare ka qëndruar në banesën e tyre në Shkodër, për një periudhë kohore para vitit 1990, arsye kjo që tezja dhe bashkëshorti i saj kanë pasur dhe kanë një marrëdhënie respekti, mirënjohje dhe besimi me prindërit e tij. Me përgjigjet e pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 6 (gjashtë) “lajmërim kreditimi”,<sup>17</sup> të urdhëruara nga llogaritë bankare në emër të tezes Z. A. dhe të kompanisë së ndërtimit “{\*\*\*}”, në emër të kësaj të fundit dhe të bashkëshortit Z. A., në ShBA, drejt llogarisë bankare të babait të tij, E. B.

**23.2.3.** Ndërsa sa i përket depozitimeve fizike nga babai, në monedhat EUR dhe USD, pranë “Bankës Kombëtare Tregtare” ShA dhe “Intesa SanPaolo Bank” ShA, kërkesës së Komisionit për të provuar me dokumentacion justifikues burimin dhe destinacionin e tyre, subjekti i rivlerësimit sqaron se nga komunikimi me babain, tezen dhe bashkëshortin e saj, si dhe nga analizimi i llogarive bankare, të gjitha transaksionet bankare janë kryer nga babai i tij, me qëllim ruajtjen dhe kthimin e vlerave monetare në momentin kur do të kërkoheshin nga tezja dhe bashkëshorti i saj. Të gjitha shumat,

---

<sup>17</sup> Subjekti i rivlerësimit depoziton gjashtë “lajmërim kreditimi”, transferta në llogarinë bankare të z. E. B. (nr. llogarie {\*\*\*}, në USD) në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, që provojnë konkretisht transferimet: (i) me urdhërues Z. A., me adresë “{\*\*\*}”, të shumës 9.985,00 USD, më datë 07.05.2003; (ii) me urdhërues Z. A., me adresë “{\*\*\*}”, të shumës 9.335,97 USD, më datë 30.09.2003; (iii) me urdhërues “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, të shumës 19.970 USD, më datë 23.09.2004; (iv) me urdhërues “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, të shumës 4.990 USD, më datë 01.09.2004; (v) me urdhërues Z. C. A., “{\*\*\*}”, të shumës 790 USD, më datë 02.11.2004; (vi) me urdhërues Z. C. A., “{\*\*\*}”, të shumës 1.490 USD, më datë 23.12.2004.

përveç asaj 20.000 euro, depozituar më datë 07.05.2007, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, janë vlera monetare të tezes dhe të bashkëshortit të saj, dhe babai i tij, thjesht, është kujdesur për t’i ruajtur ato, pa pasur asnjë përfitim nga fondet e mbërritura apo të lëvizura në këto llogari bankare, apo interesat e përfituara nga depozitat e krijuara, as ai dhe aq më pak subjekti i rivlerësimit. Llogaritë bankare janë mbyllur në fillim të vitit 2007 dhe shumat monetare kanë kaluar herë pas here në kohë, te pronarët e tyre të vërtetë, te zja dhe bashkëshorti i saj, për interesat e tyre. Ndërsa, për llogarinë rrjedhëse në “Intesa SanPaolo Bank” ShA, subjekti i rivlerësimit sqaron se rezultoi një depozitim *cash* prej 2.000 USD, më datë 15.04.2003, dhe një depozitim 30.000 USD, më datë 09.09.2005, tërhequr brenda muajit, më datë 28.09.2005. Këto shuma, sipas subjektit të rivlerësimit, kanë si burim vlerat monetare të sjella fizikisht nga te zja dhe familjarët e saj, gjatë vizitave të tyre në Shqipëri, në vitet 2000. Shumat janë depozituar dhe tërhequr me kërkesën e tezes.

**23.2.4.** Në kushtet kur, përveç transfertave bankare dhe shumës 32.000 USD, depozituar *cash*, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, ka pasur edhe disa tërheqje dhe depozitime *cash* nga babai i subjektit të rivlerësimit, në këto dy banka, subjekti i rivlerësimit sqaron se: (i) shuma 16.240 USD, depozituar nga babai në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, më datë 03.02.2004, ka si burim dy shumat e tërhequra nga kjo bankë, 9.985 USD, më datë 09.05.2003, mbërritur me transfertë prej tezes nga ShBA-ja, më datë 07.05.2003, dhe shumës 9.355,97 USD, më datë 30.09.2003, mbërritur po me transfertë nga te zja, në të njëjtën datë; (ii) shuma 16.252 USD, depozituar nga babai në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, më datë 13.05.2004, ka si burim dy tërheqjet e kryera në “Intesa SanPaolo Bank” ShA, konkretisht shumën 5.000 USD, më datë 12.03.2004, dhe shumën 11.252.03 USD, më datë 13.05.2004; (iii) për shumën 25.000 USD, të depozituar *cash* në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, më datë 14.04.2005, burimi i krijimit është tërheqja e shumës 25.344 USD nga babai i tij, në të njëjtën datë, nga “Intesa SanPaolo Bank” ShA.

**23.3.** Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision, më datë 02.07.2021, midis të tjerash, dhe dy deklarata të tezes së tij, znj. Z. A.<sup>18</sup>, si vijon:

**23.3.1.** Deklaratën e datës 21.06.2021, në të cilën te zja deklaroi se ndodhet në pamundësi për të marrë “*Individual Income Tax Returns*” nga IRS<sup>19</sup>, pasi jepen vetëm për 7 (shtatë) vitet e fundit, dhe dërgon origjinalet e deklaratave tatimore të të ardhurave individuale në ShBA,<sup>20</sup> të bashkëshortëve Z. dhe Z. A., për vitet 1999 – 2005.

**23.3.2.** Deklaratën e datës 25.06.2021, në të cilën te zja deklaroi se, që prej vitit 1993 deri në vitin 2007, ajo ka qenë e punësuar në restorant, ndërsa bashkëshorti në ndërtim. Në vitin 2001, së bashku me bashkëshortin, kanë regjistruar kompaninë “{\*\*\*}”<sup>21</sup> me aktivitet në fushën e rindërtimit dhe ndërtimit, kryesisht të banesave në zonën ku banojnë. Me regjistrimin e kompanisë kanë hapur llogari bankare për veprimet e saj financiare, e cila nuk ka pasur probleme financiare dhe, përveç bashkëshortit, ka pasur të punësuar dhe persona të tjerë. Deklaruesja shprehet se ka pasur llogari të përbashkët me bashkëshortin që prej vitit 1993 deri aktualisht. Gjatë periudhës 1999-2008, deklaroi se ajo, bashkëshorti, por dhe djemtë kanë shkuar në Shqipëri pothuajse çdo vit, kryesisht gjatë stinës së verës, por edhe në periudha të tjera. Ajo deklaroi, gjithashtu, se ka pasur një marrëdhënie të ngushtë me motrën dhe bashkëshortin e saj që përpara viteve 1990, kur ishte vajzë, pavarësisht se

<sup>18</sup> Mbajtur përpara noterës publike, në New Jersey, A. O.

<sup>19</sup> “IRS”, akronim për Internal Revenue Service.

<sup>20</sup> U.S Individual Income Tax Return.

<sup>21</sup> Me adresë “{\*\*\*}”.

kanë jetuar në qytete të ndryshme (Shkodër dhe Bilisht). Edhe pas viteve '90, gjatë emigrimit në Greqi e në ShBA, marrëdhëniet e tyre kanë qenë po aq të ngushta, përfshirë edhe bashkëshortin Z. A. Për shkak të kësaj marrëdhënieje, së bashku me bashkëshortin dhe me dakordësinë e motrës, S. B., dhe të bashkëshortit të saj, E. B., kanë dërguar vlera monetare në USD, nga llogaritë bankare të tyre dhe të kompanisë, si dhe fizikisht, kur kanë ardhur në Shqipëri, në llogarinë bankare të E. B. dhe në banesën e tij. Për vlerat monetare të dërguara nëpërmjet llogarive bankare, deklaruesja shprehet se i kanë kërkuar E. B. për të hapur një llogari bankare, ku më pas, me dëshirën dhe interesin e tyre, këto vlera janë transferuar dhe janë mbajtur në llogari bankare të ndryshme nga E. B., deri në momentin e tërheqjes. Qëllimi i dërgimit të tyre, sipas deklarueses, ka qenë për t'i përdorur ato për blerjen e një sipërfaqe toke dhe ndërtimin e një shtëpie në qytetin e Tiranës, qëllim i cili nuk u realizua për shumë shkaqe, kryesisht për shkak se në disa raste i është dashur të përdorë vlerat monetare për shpenzime në Shqipëri, siç ka qenë rasti për të rindërtuar shtëpinë e vjetër të bashkëshortit në qytetin e Bilishtit, në vitin 2005, apo edhe për shkak të krizës financiare në ShBA. Në këtë deklaratë, znj. A. shprehet gjithashtu se të gjitha vlerat monetare të transferuara dhe të sjella fizikisht prej vitit 2002 deri në vitin 2007, të depozituara në llogaritë bankare të z. E. B., si dhe ato të sjella fizikisht herë pas here në Shqipëri, të depozituara në llogari bankare, kryesisht në vitin 2005 dhe të tërhequra po në atë vit prej tij, janë të deklarueses Z. A., bashkëshortit dhe djemve të saj. Ajo deklaron se E. B., përveçse i ka mbajtur, nuk i ka përdorur dhe nuk ka përfituar as interesa bankare prej tyre. Të gjitha vlerat monetare, të depozituara dhe tërhequra nga E. B., janë marrë nga deklaruesja dhe familjarë të saj, fizikisht, pas vitit 2007, herë pas here, por jo më vonë se viti 2012.

**23.4.** Gjatë hetimit administrativ, në kushtet kur ka rezultuar se znj. Z. A. i ka transferuar babait të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet bankës shumë 46.561 USD, si dhe është deklaruar se janë sjellë fizikisht prej saj shumat 2.000 USD dhe 30.000 USD, tërhequr dhe dhënë *cash* tezes nga babai, Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit (më datë 01.07.2021), duke i kërkuar shpjegime shteruese lidhur me destinacionin e këtyre shumave, si dhe dokumentacion mbi shumat *cash* të deklaruara nga znj. Z. A., në momentin e hyrjes në Shqipëri për shumat e sjella, dhe deklarimin në momentin e daljes nga Shqipëria dhe hyrjes në territorin e ShBA-së, për shumat e kthyer.

**23.4.1.** Në përgjigjet e tij të datës 05.07.2021, në vijim të shpjegimeve të dhëna më parë lidhur me mosdijësinë e ekzistencës së këtyre vlerave monetare apo gjendjes psikologjike jo të mirë të babait, subjekti i rivlerësimit shprehet se, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, vlerat monetare të transferuara apo sjella fizikisht, nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo nuk kanë sjellë përfitim monetar për të apo familjarët e tij. Pasi i referohet shpjegimeve të tezes në deklaratën e datës 25.06.2021, të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka komunikuar përsëri me tezen në kuadër të këtij pyetësi dhe është informuar se shuma prej 30.000 USD, depozituar *cash* në bankë nga babai, në fillim të muajit shtator 2005, nuk është sjellë e tëra në atë periudhë kohore, por është sjellë fizikisht ndër vite, gjatë udhëtimeve të tyre në Shqipëri. Një pjesë e kësaj shume, e pa specifikuar saktësisht, është sjellë në vitin 2005, në momentin kur kanë ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në ceremoninë e dasmës së subjektit të rivlerësimit. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, dëshira e tyre ka qenë që shuma të depozitohet në llogari bankare nga babai dhe, meqenëse në atë periudhë kanë pasur nevojë për vlera monetare për rregullimin e banesës, në qytetin e Bilishtit, me kërkesën e të afërmeve të bashkëshortit, teza dhe bashkëshorti i saj i kanë kërkuar babait tërheqjen e shumës 30.000 USD, brenda muajit shtator 2005. Në lidhje me kalimin e vlerave monetare fizikisht, në pikat e kalimit kufitar në Shqipëri dhe në ShBA, si në ardhje, ashtu edhe në kthim, subjekti i rivlerësimit i referohet gjithashtu shpjegimeve të dhëna nga teza, se kanë respektuar kufirin e detyrueshëm të deklarimit të

vlerave monetare përpara autoriteteve doganore respektive dhe, në asnjë rast, nuk ka qenë e detyruar apo nuk u është kërkuar deklarimi i tyre.

23.5. Lidhur me depozitimet *cash* të shumës 2.000 USD, më datë 15.4.2003 dhe 30.000 USD, më datë 09.09.2005, të kryera nga babai, në përgjigjet e pyetësorit të datës 24.09.2021, kërkesës së Komisionit për të depozituar *statement*<sup>22</sup> bankar të llogarive të tezes dhe familjarëve të saj (bashkëshortit) për periudhën 2000 – 2012, subjekti i rivlerësimit sqaron se avokati i tyre e kishte konsideruar jo të rregullt dërgimin e të dhënave personale në mënyrë indirekte nëpërmjet subjektit të rivlerësimit në Komision. Pavarësisht dërgimit më herët të të dhënave lidhur me të ardhurat familjare, kryesisht nga aktiviteti privat në fushën e ndërtimit, sa i përket lëvizjeve të llogarive bankare, subjekti i rivlerësimit shprehet se ka hasur në hezitimin e të afërmeve të tij për dërgimin e tyre, megjithatë ata u janë drejtuar institucioneve bankare për sigurimin e këtyre të dhënave.

23.6. Komisioni, pasi hetoi në lidhje me shumat e dërguara me transfertë bankare, shumat e depozituara në *cash*, burimin e krijimit të tyre, investimet e mundshme në pasuri të paluajtshme të kryera në Shqipëri,<sup>23</sup> nga teza dhe bashkëshorti i saj, destinacionin dhe kohën e kthimit të shumave tezes, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve se: -  
- ngrihen dyshime mbi destinacionin dhe kthimin e vlerave monetare të tezes së subjektit të rivlerësimit, në total në shumën 78.561 USD; -- duket se teza dhe familjarët e saj kanë pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 24.875 USD, për shumat e dërguara në Shqipëri.

23.6.1. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë mundësinë e kursimit që teza dhe bashkëshorti i saj kanë pasur për periudhën 23 maj 1993 – dhjetor 1998, që për shkak të kohës së gjatë, që ka kaluar mbi 20 vjet dhe faktit që për këtë periudhë kanë qenë në shtetin e New York-ut dhe jo në New Jersey, ku banojnë aktualisht, bëjnë të pamundur sigurimin e dokumenteve për të ardhurat e kësaj periudhe. Madje, edhe dokumentacioni për periudhën 1999 - 2005, i paraqitur në Komision, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë i ruajtur prej tezes në arkivin e saj, në të kundërt do të ishte e pamundur të sigurohej. Në kushtet e pamundësisë objektive për të paraqitur akte të tjera shkresore për të ardhurat e siguruar nga teza, subjekti i rivlerësimit i kërkon Komisionit që të mbahen parasysh parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>24</sup>, ndërkohë që për shumat e dërguara me transferta bankare vlerëson se janë kontrolluar nga banka dhe shteti dërgues, për burimin e krijimit dhe ligjshmërinë e të ardhurave. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton përllogaritjen e Komisionit lidhur me shpenzimet jetike të familjes së tezes për periudhën 1999 - 2005, duke pretenduar korrigjimin e pamjaftueshmërisë financiare nga (-) 24.875 USD në (-) 8.724 USD, pamjaftueshmëri të cilën e konsideron të parëndësishme në raport me shumën e dërguar gjithsej, si dhe faktin që Komisioni në analizën e kryer ka konsideruar vitin 1999, si pikën zero, ndërkohë që duhet të merrte në konsideratë mundësinë e kursimit të tezes dhe të bashkëshortit, deri

---

<sup>22</sup> *Statement* = lëvizje të llogarive bankare.

<sup>23</sup> Nga verifikimi i kryer në sistemin e AShK-së, sipas Komisionit, ka rezultuar vetëm një pasuri me nr.{\*\*\*}, "Arë", me sipërfaqe 4799 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese 1/36 secili, e përfituar me trashëgimi ligjore, ku ndër të tjerë janë znj. Z. A., së bashku motrën e saj, znj. S. B. (nëna e subjektit). Ndërsa bashkëshorti i tezes nuk ka rezultuar pronar në ndonjë pasuri të paluajtshme.

<sup>24</sup> Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: "Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor".

në vitin 1998, bazuar qoftë edhe me ndonjë metodë alternative përlllogaritjeje.

**23.6.2.** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet, shton argumentet duke pretenduar se shumat e dërguara janë tërhequr dhe pjesa më e madhe e tyre është transferuar me bankë, gjë që heq çdo dyshim mbi kthimin e tyre. Këto shuma, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk janë përdorur asnjëherë as prej tij dhe as nga prindërit për krijimin e ndonjë pasurie të luajtshme apo të paluajtshme. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tezes, subjekti i rivlerësimit vlerëson se, duke marrë në konsideratë faktin që shuma e depozituar në llogarinë e babait, nuk është konsideruar asnjëherë likuiditet i tij, nuk është përdorur prej tij, ashtu siç vetë Komisioni konstaton, nuk ka pasur asnjë ndikim në pasuritë e krijuara nga babai apo në shpenzimet familjare, si dhe është kthyer përpara plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit vlerëson se nuk është i detyruar nga ligji për të justifikuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, pasi tezja në kushtet e sipërcituara dhe referuar parashikimeve të nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur.

**23.7.** Në mbështetje të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, gjatë seancës dëgjimore të datës 25.10.2021, subjekti i rivlerësimit depoziton dy akte shkresore: (i) “vërtetim”, datë 10.10.2021, të znj. Z. A., në të cilin shprehet mbi mbërritjen në ShBA dhe punësimin e saj dhe të bashkëshortit në shtete të ndryshme (New York, Pensilvani dhe New Jersey), duke vënë në dispozicion në disa raste dhe adresën/kontakte të vendeve ku ka qenë e punësuar. Në këtë vërtetim, znj. A. përsërit në mënyrë përfundimtare se motra dhe bashkëshorti nuk kanë përdorur në asnjë rast për nevoja të tyre, shumat e dërguara prej saj, si nëpërmjet llogarisë bankare apo të sjella fizikisht, të cilat deklaron t’i ketë shpenzuar në Shqipëri, si dhe t’i ketë marrë fizikisht; (ii) dokumentin e lëshuar nga PNC Bank, më datë 05.10.2021, në të cilin citohet: *“Çeqet, mandatet e depozitimeve dhe lëvizjet e llogarive bankare, mbahen për shtatë vjet. Kërkesa për të dhëna përtej afatit 7-vjeçar nuk mund të përmbushet”*.

**23.8.** Komisioni në vendim ka konkluduar se nuk u provua prejardhja e shumave të konsiderueshme monetare të depozituara *cash*, të disponuara për shumë vite, nga viti 2003, në llogaritë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ky i fundit prej vitit 2001 ushtronte detyrën prokurorit, në mungesë të burimeve të ligjshme financiare, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pa u provuar pretendimi se ato shuma i përkisnin tezes së subjektit dhe se ishin transferuar prej saj personalisht apo nëpërmjet personave të tretë nga ShBA-ja në Shqipëri.

**23.9.** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, por edhe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj, më datë 08.04.2024, trupi gjykues konstaton paqartësi për vlerën e shumave të depozituara *cash*, që Komisioni i konsideron pasuri të familjes së subjektit të rivlerësimit dhe një tentativë të këtij të fundit, për të evituar verifikimin dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare e krijimit të tyre.

**23.9.1.** Kjo për faktin se në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni vlerëson se për shumat *cash* të depozituara nga babai në llogaritë e veta bankare, nuk është provuar burimi i ligjshëm, ku përveç shumave në USD përfshin dhe shumën 20.000 euro, e cila ashtu siç do të trajtohet në vijim në këtë vendim, është pasuri e familjes së subjektit të rivlerësimit, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, në Tiranë, më datë 16.08.2007, dhe që Komisioni e kishte trajtuar dhe vlerësuar më herët në vendimin e tij.

**23.9.2.** Përpos këtij fakti, Komisioni në vendim<sup>25</sup> shprehet se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në

---

<sup>25</sup> *Shih faqen 37 të vendimit nr. 469, datë 01.11.2021, të Komisionit, objekt shqyrtimi.*

mënyrë të detajuar transaksionet (depozitimet dhe tërheqjet) e kryera në llogaritë bankare të babait, duke paraqitur dokumentacion mbështetës për veprimet bankare, ndërkohë që lë pa vlerësim nëse i konsideron bindëse këto shpjegime të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilave, vetëm shumat 2.000 USD, depozituar më datë 15.04.2003, dhe 30.000 USD, depozituar më 09.09.2005, pranë “Intesa Sanpaolo Bank” ShA janë fonde të sjella fizikisht nga tezja e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj gjatë vizitave në Shqipëri, pjesa tjetër e depozitimeve në *cash* e ka prejardhjen nga shumat e transferuara nga tezja nëpërmjet bankës. Po kështu, një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve që Komisioni në vendim vlerëson të mbetura pa përgjigje dhe shpjegime bindëse nga subjekti i rivlerësimit, i referohen pikërisht shumave të sjella fizikisht (32.000 USD), pasi ka verifikuar mundësinë financiare të tezes së subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj për të krijuar shumën 78.561 USD, si dhe ka ngritur dyshime mbi destinacionin dhe kthimin e vlerave monetare të tezja po për këtë shumë, që përbëhet konkretisht nga transfertat bankare në vlerën totale 46.561 USD, dhe shumat e pretenduara të sjella fizikisht, në vlerën 32.000 USD në total.

**23.10.** Nga analizimi i llogarive bankare në emër të babait të subjektit, trupi gjykues konstaton se nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank” ShA janë transferuar 46.561 USD nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me urdhërues Z. A. dhe shoqërinë “{\*\*\*}”. Në të njëjtën llogari bankare janë depozituar në *cash* nga z. E. B., shumat 2.000 USD dhe 30.000 USD. Duke pasur parasysh shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se llogaria rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA ka shërbyer si llogari pritëse e fondeve të transferuara nga ShBA, ndërsa llogaria bankare në “Bankën Kombëtare Tregtare” ka shërbyer si llogari depozitimi e tyre, duke konsideruar të besueshme tërheqjet dhe depozitimet *cash* nga njëra bankë në tjetrën (shih paragrafin 23.2.4 në këtë vendim), ndodhur në kushtet kur shumat e transferuara nëpërmjet bankës nga llogaritë bankare të tezes në ShBA, prej 46.561 USD, nuk lenë dyshim për prejardhjen e tyre, trupi gjykues vlerësoi të kufizojë analizën e tij në shumën e pretenduar, të sjellë fizikisht, prej 32.000 USD, shpjegimet për të cilën mbeten në nivel deklarativ, pa gjetur mbështetje në ndonjë dokument provues të kohës.

**23.11.** Në mbështetje të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse nuk i konsideron të logjikshme lëvizjet e herëpashershme nga babai i subjektit të rivlerësimit të shumave të konsiderueshme në monedhën USD, brenda së njëjtës bankë, nga një bankë në tjetrën, apo edhe tërheqjen dhe mbajtjen e tyre në banesë për një kohë të gjatë nga janari 2007, përpara se t’ia kthente fizikisht tezes së subjektit të rivlerësimit, në muajin gusht të vitit 2007 apo vitin 2012, vite në të cilat, sipas të dhënave të sistemit TIMS, ajo ka ardhur në Shqipëri, trupi gjykues për shkak të paqartësive në vendimin e Komisionit lidhur me këto shuma, nuk i jep peshë në këtë çështje kthimit të tyre. Për më tepër, trupi gjykues konstaton deklarime kontradiktore të tezes në deklaratën e datës 25.06.2021, për faktin se nga njëra anë ajo deklaron se në disa raste, shumat i ka përdorur për shpenzime gjatë qëndrimit në Shqipëri, siç ka qenë rasti për të rindërtuar shtëpinë e vjetër të bashkëshortit në qytetin e Bilishtit, në vitin 2005, apo edhe nga kriza financiare në ShBA, ndërsa nga ana tjetër shprehet se të gjitha vlerat monetare, të depozituara dhe të tërhequra nga E. B. janë marrë prej saj dhe familjarëve, fizikisht, pas vitit 2007, herë pas here, por jo më vonë se viti 2012. Në përfundim, duke qenë se kthimi i shumës 46.651 USD nuk ngre dyshime, për faktin se provohet prejardhja e saj nga tezja dhe bashkëshorti, trupi gjykues nuk u ndal më tej në analizimin e mënyrës së kthimit të shumës së mbetur, duke e konsideruar pa efekt në vendimmarrjen për këtë çështje.

**23.12.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ndodhet në kushtet e fshehjes së pasurisë, pasi nuk ka pasur detyrimin të deklarojë llogaritë bankare të babait, si person i lidhur, as ndër vite në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, kur këto shuma nuk ekzistonin dhe nuk janë pretenduar si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, trupi gjykues me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, që konsideron fshehje pasurie rastet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasuri të krijuara prej tij apo personave të lidhur, që ekziston në kohën e dorëzimit të kësaj deklaratë, ndryshe nga Komisioni nuk e kualifikon situatën e parashtruar më sipër, në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c”, të ligjit nr. 84/2016, por si përmendur më sipër, analizon nëse subjekti i rivlerësimit mund të provojë që shuma 32.000 USD i përket tezes dhe familjes së saj.

**23.13.** Në ankim, përveç shpjegimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, për të provuar që shumat e depozituara *cash* në llogaritë bankare të babait i përkasin tezes, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje të Kolegjit se: (i) përzgjedhja e këtyre bankave është bërë për faktin se “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, në atë periudhë kohe ka qenë emërtuar “Banka Amerikane e Shqipërisë”, e preferuar nga shtetas të huaj, kryesisht amerikanë, ndërsa “Banka Kombëtare Tregtare” ka qenë ndër bankat e nivelit të dytë më të njohura në tregun bankar në Shqipëri; (ii) depozitimi i shumave *cash* (2.000 USD dhe 30.000 USD) nga babai në llogaritë bankare të çelura dhe të përdorura për transfertat dhe depozitimin e shumave nga ShBA, tregojnë se këto shuma kanë të njëjtën prejardhje dhe burim, tezen dhe familjen e saj; (iii) depozitimi *cash* nga babai i shumës 30.000 USD, më datë 09.09.2005, kur teza dhe familjarët e saj ndodheshin për vizitë në Shqipëri është një rrethanë që tregon dhe nuk lë vend për interpretim, se këto vlera monetare i përkisnin tezes dhe janë depozituar në llogari bankare me dëshirë të saj; (iv) tërheqja e kësaj shume brenda tri javëve nga depozitimi i saj ka ndodhur me kërkesë të tezes për përdorim nga të afërmit e bashkëshortit të saj, për mirëmbajtjen dhe riparimin e banesës së përbashkët me vëllezërit e tij, në rrethin e Korçës. Këto fakte, sipas subjektit të rivlerësimit janë bindëse, pasi nuk ka arsye dhe logjikë ekonomike, të depozitimit dhe tërheqjes brenda një kohe shumë të shkurtër të një shume të konsiderueshme; (v) çelja e llogarive bankare nga babai për fondet e tezes dhe familjarëve të saj, është bërë në monedhën dollarë amerikanë, ashtu sikurse janë dhe vlerat monetare të përdorura prej tyre në ShBA, pasi nëse do të kishin si burim të ardhurat e familjes së subjektit, do të ishte më e logjikshme dhe përfituese nga ana ekonomike bashkimi i tyre me shumën 20.000 euro, kursime të familjes.

**23.14.** Pavarësisht pretendimeve dhe argumenteve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nisur nga fakti që ai ka potencuar se shuma 30.000 USD nuk është sjellë e gjitha në vitin 2005, kur teza dhe familjarët e saj kanë vizituar Shqipërinë dhe kanë marrë pjesë në ceremoninë e dasmës së subjektit të rivlerësimit, por është një shumë e sjellë ndër vite, përfshirë dhe vitin 2005, situata faktike e parashtruar në këtë çështje, ashtu si përmendur edhe nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, edhe për trupin gjykues spontanisht ngre një sërë pikëpyetjesh të pashmangshme. Së pari, përse këto shuma nuk u transferuan nëpërmjet sistemit bankar, ashtu si në rastet e tjera, ku teza ka përdorur këtë kanal për të dërguar në llogarinë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit shuma të ndryshme nga 790 USD deri në 19.970 USD, gjatë periudhës 07.05.2003 deri më 23.12.2004. Së dyti, nëse nisur nga pretendimet e tezes në deklaratën e datës 25.06.2021, se ajo, bashkëshorti dhe djemtë kanë ardhur pothuajse çdo vit gjatë periudhës 1999 – 2008 dhe sqarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore se ata kanë ardhur në vitet 1998 – 2001, 2003, 2004, pastaj në 2005, atëherë përse babai do të akumulonte dhe mbante fizikisht shumën 30.000 USD dhe do të priste deri në shtator të vitit 2005 që ta depozitonte atë në llogari bankare, ndërkohë që mund ta kishte bërë në vitet 2003 dhe

2004, apo deri në prill 2005, kur rezultojnë të jenë dërguar transfertat bankare, dhe të jenë kryer nga babai i subjektit të rivlerësimit një sërë tërheqjesh dhe depozitimesh në këto llogari. Së treti, mbeti në nivel deklarativ pa u mbështetur në asnjë dokument provues të kohës, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se tërheqja nga llogaria bankare e shumës 30.000 USD është bërë me kërkesë të tezes dhe u është dhënë të afërmeve të bashkëshortit të saj, për mirëmbajtjen dhe riparimin e banesës së përbashkët që ai ka me vëllezërit në rrethin e Devollit. Ndërkohë që vetë tezja, në deklaratën e datës 25.06.2021, nuk përcakton shumën e përdorur për këtë qëllim, dhe nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore shprehet se shuma prej 30.000 USD, nuk është kthyer menjëherë, një pjesë e saj është përdorur për riparimin e shtëpisë në pronësi të të afërmeve të bashkëshortit të tezes. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte që shuma 32.000 USD i përkiste tezes dhe familjes së saj.

23.15. Për sa arsyetuar më sipër, lidhur me shumat monetare 2.000 USD dhe 30.000 USD, të depozituara *cash* nga babai i subjektit të rivlerësimit, në llogarinë e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, respektivisht në datat 15.04.2003 dhe 09.09.2005, të pretenduara me burim nga tezja e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se i përkasin familjes së subjektit të rivlerësimit, e në kushtet e përfshirjes së tyre në analizën e kryer për verifikimin e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, ai dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme, sipas përcaktimit të kësaj dispozite, konstatohet e pavarur nga kontrolli i analizës financiare që Komisioni ka kryer për krijimin e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>”, në Tiranë, në gusht të vitit 2007, dhe vjen si pasojë e arsytimit logjik të termave financiarë.

*Për apartamentin në pronësi të babait, blerë në vitin 2007, si dhe depozitim prej tij të shumës cash 20.000 euro, në datën 07.05.2007, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA*

24. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë qenë në pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me burime të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, krijimin e shumës 20.000 euro, të depozituar *cash* në datën 07.05.2007, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, si dhe blerjen e apartamentit në datën 16.08.2007, në vlerën 3.000.000 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë “Apartament”, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
25. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar Komisionin lidhur me mungesën e burimeve financiare konstatuar prej tij, duke pretenduar se: (i) konkluzioni mbi burimin e ligjshëm të këtyre pasurive është i njëanshëm dhe i padrejtë, në kundërshtim me provat e administruara, në vlerësim dhe interpretim të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016; (ii) konkluzioni mbi burimin e ligjshëm të shumës 20.000 euro dhe mosdijeninë e subjektit të rivlerësimit për ekzistencën e kësaj shume (depozite), si dhe për kursimet *cash* ndër vite, janë të gabuara, alogjike, abuzive, të paargumentuara e të pambështetura në prova, ndonëse në kuadër të një hetimi administrativ, sërish bindja dhe mendimi duhet të jenë të bazuara në prova, rrethana dhe të argumentuar; (iii) sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, prindërit nuk kanë gëzuar statusin e personit të lidhur dhe nuk kanë pasur detyrimin për deklarimin e kursimeve *cash*, pavarësisht se kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare me



subjektin e rivlerësimit, qëndrim i konsoliduar i Komisionit dhe i Kolegjit<sup>26</sup>; (iv) Kolegji duhet të vlerësojë në tërësi analizën e Komisionit, mbi burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, pasi konkludimet e tij nuk janë në përputhje me faktet dhe rrethanat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, dhe për këtë shkak, vendimi i Komisioni për këtë pasuri duhet të ndryshohet në favor të konfirmimit të subjektit të rivlerësimit në detyrë.

26. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni, për trupin gjykues situata faktike paraqitet si vijon:

26.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: apartament banimi, me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Tiranë, blerë me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08.2007, në vlerën 3.000.000 lekë. Bashkëpronësi me të gjithë personat sipas certifikatës familjare. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit deklaroi: -- të ardhurat e përfituara nga pagat në funksionin e prokurorit, -- të ardhurat e babait nga pensioni i parakohshëm, pensioni suplementar, si dhe pensioni i pleqërisë. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe të ardhurat e përfituara prej tij nga punësimi në sektorin privat, -- të ardhurat e nënës nga pensioni i pleqërisë, si dhe punësimi i saj në sektorin privat.

Në deklaratën periodike vjetore 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi apartamentin për herë të parë, por nuk deklaroi burimin e krijimit të tij.

26.2. Kjo pasuri është përfutur nëpërmjet kontratë shitje, pasuri e paluajtshme (apartament) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08.2007, nënshkruar mes shitësve A. dhe M. R. dhe blerësit E. B., në vlerën 3.000.000 lekë, shumë të cilën palët e deklarojnë të paguar nga blerësi në favor të shitësit jashtë zyrës noteriale, pa pretendime nga palët. Referuar informacionit të përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2019, apartamenti me sipërfaqe 53.03 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, Tiranë, figuron i regjistruar në emër të z. E. B.

26.3. Në kuadër të hetimit administrativ, nga informacioni i siguruar nga bankat e nivelit të dytë, Komisioni ka konstatuar se babai i subjektit të rivlerësimit, E. B., ka depozituar më datë 07.05.2007, shumën 20.000 euro, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA<sup>27</sup>, shumë të cilën e tërheq më datë 08.08.2007. Ndërsa subjekti i rivlerësimit rezulton që, më datë 02.08.2007, të ketë tërhequr nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank” ShA<sup>28</sup> shumën 1.650.000 lekë, të akumuluar nga paga ndër vite. Këtë shumë, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2007 apo në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim financiar për blerjen e apartamentit, më datë 16.08.2007.

26.4. Pas kërkesës së Komisionit për dokumentacion provues mbi çdo burim të ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 53,03 m<sup>2</sup> më datë 16.8.2007, me përgjigjet e pyetësorit të datës 19.04.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e babait nga pensioni i parakohshëm (pagesë kalimtare), pensioni suplementar, pensioni i pleqërisë, të ardhurat e nënës nga pensioni i pleqërisë, si dhe të ardhurat e tij në funksionin e prokurorit në

<sup>26</sup> Shih vendimin nr. 410, datë 30.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; vendimin (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit N. K.

<sup>27</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2019.

<sup>28</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2019.

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë.

**26.5.** Për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga punësimi i prindërve në sektorin privat, subjekti i rivlerësimit sqaron konkretisht se, për të ardhurat nga punësimi i babait: (a) si punonjës i sigurisë fizike pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “{\*\*\*}”, për periudhën shtator 2001 deri në vitin 2003, në shumën 420.000 lekë, nuk disponon dokumentacion përkatës, pasi administratori ka ndryshuar dhe për shkak të kohës, nuk ka pasur mundësi ta kontaktojë për të mundësuar këtë dokumentacion. Subjekti i rivlerësimit depoziton dokumentacionin e siguruar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.05.2021, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet së cilës i janë përcjellë kopje të dokumenteve mbi regjistrimin e aktivitetit të subjektit tregtar “{\*\*\*}” ShPK<sup>29</sup>; (b) të ardhurat e përfituara nga babai, nga punësimi si punonjës i sigurisë fizike pranë shoqërisë së ruajtjes fizike “{\*\*\*}s” ShPK (në vijim “{\*\*\*}” ShPK), prej muajit janar 2004 deri në tetor 2007, në shumën 920.000 lekë. Për këtë, subjekti i rivlerësimit paraqiti: (i) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 04.05.2021, lëshuar nga shoqëria e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “{\*\*\*}” ShPK Lezhë, në të cilin shkruhet se: *E. B. ka punuar si punonjës shërbimi, roje objektësh, nga data 01 janar 2004 deri më 30 tetor 2007, dhe është paguar me pagë mujore nga 20.000 lekë deri në 25.000 lekë në muaj. Gjatë kësaj periudhe, personi në fjalë ka punuar part time dhe si ish-ushtarak, nuk ka derdhur kontribute sigurime shëndetësore, pasi ka qenë me pension të parakohshëm;* (ii) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2021, lëshuar në vijim të vërtetimit të datës 04.05.2021 nga kjo shoqëri, me lëndë: *shpjegime për pagesën e punonjësit E. B., për periudhën janar 2004 - 31 tetor 2007, dhe (iii) ekstrat historik të regjistrimit tregtar për këtë subjekt. Për të ardhurat e nënës nga punësimi në sektorin privat, si banakiere në lokalin bar-kafe “{\*\*\*}”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekt tregtar, personi fizik “{\*\*\*}”, për periudhën shtator 2001 deri në vitin 2007, të pretenduara në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar për të provuar këto të ardhura: (i) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.05.2021, të E. P. dhe V. P., të cilët deklarojnë se gjatë viteve 2002 deri në vitin 2010 janë marrë me administrimin e bar-kafe “{\*\*\*}”, regjistruar si person fizik “{\*\*\*}” dhe krahas tyre në këtë biznes ka qenë e punësuar edhe S. B. në pozicion banakiere, e cila për punën që bënte, shpërblehej me vlerën 12.000 lekë në muaj nga viti 2001 deri në vitin 2007; (ii) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, në të cilën citohet se: *subjekti “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, është regjistruar në sistemin informatik për llojin e aktivitetit “Bar Kafe” [...] në vitin 2001, ka të deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 4-5 milionë lekë dhe është me status aplikim për çregjistrim më datë 26.10.2010. Subjekti ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore nga data e regjistrimit 01.01.2001 deri më datën 26.10.2010, kur ka kaluar me status aplikim për çregjistrim në QKB.**

---

<sup>29</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 10.09.1994, “Për regjistrim si person juridik”; Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2001, i gjyqtarit të vetëm, lidhur me regjistrimin e vendimit të asamblesë së ortakëve për depozitimin e kontratës së shitjes së kuotave nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.12.2000; Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, datë 19.11.2001, i gjyqtarit të vetëm, lidhur me depozitimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.11.2001, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe depozitimin e kontratës së shitjes së kuotave nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.11.2001; Statusin e shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK; Akt-Marrëveshje “Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (ShPK) “{\*\*\*}” me ortakëri; Deklaratë, datë 02.11.2001, të “Alpha Bank” ShA, me anë të cilës vërteton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me president z. S. M., është kliente e bankës, regjistruar në librat e saj dhe me llogari aktive në USD dhe ALL, dhe me tepricë kreditore 4.000.000 lekë, si dhe kontrata shitblerjen kuotash, vendime asambleje dhe kërkesa për regjistrimin e tyre.

26.6. Lidhur me pjesën takuese në bashkëpronësi, kontributin, si dhe saktësimin e vlerave të çdo burimi të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për apartamentin e blerë më datë 16.08.2007, me përgjigjet e pyetësorit të datës 25.06.2021, subjekti i rivlerësimit sqaron se, prej vitit 2001, prindërit jetojnë në Tiranë dhe kanë ndërtuar jetën e tyre pa mbështetje financiare dhe ekonomike nga të afërm të tyre, duke u munduar të kursejnë vlera monetare, nisur dhe nga parimi që në përditshmëri të bëhen shpenzimet e nevojshme dhe të domosdoshme, parim që ndiqet edhe aktualisht nga familja. Babai, sipas subjektit të rivlerësimit, gjithmonë ka mbajtur kursime *cash* në banesë për çdo nevojë dhe të papritur, si dhe në llogari bankare. Subjekti i rivlerësimit sqaron se shpenzimet ditore ose javore në familje janë mbuluar mbi bazën e një kuote të caktuar nga babai, i cili jo vetëm ka qenë kryefamiljar për efekt të certifikatës së përbërjes familjare, por edhe në administrimin e çdo të ardhure dhe shpenzimi. Bashkëpronësia e deklaruar për apartamentet e blera nga babai, më datë 04.08.2001 dhe më datë 16.08.2007, më tepër se një nocion i mbështetur juridikisht dhe real, ka qenë një opinion i shprehur nga subjekti i rivlerësimit, pa pasur qëllime të tjera dhe pa pasur dyshime që në të ardhmen, subjekti i rivlerësimit dhe anëtarët e tjerë të familjes do të ishin trashëgimtarë ligjorë të këtyre pasurive.

26.6.1. Në vijim të sqarimeve të dhëna më herët me pyetësorin e datës 19.04.2021, për të provuar punësimin e babait pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 2004 – 2007, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy akte procedurale të një procedimi penal, në të cilin babai i subjektit të rivlerësimit, z. E. B., është pyetur dhe ka dhënë sqarime në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, si përgjegjës i rojave të policisë private, si dhe shkresën e lëshuar nga administratori i kësaj shoqërie, konkretisht: (i) vendimin e datës 01.10.2007, “Për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2007”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në të cilin citohet se: “[...] në deklaratimet e tij, shtetasi E. B., përgjegjës i rojeve pranë firmës “{\*\*\*}”, sqaron se ai është në dijeni të faktit se në ato depo kishte lëndë plasëse dhe se firma ku ai punon, e ka marrë në ruajtje atë objekt që prej vitit 2005”; (ii) procesverbal të datës 06.06.2007, “Për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale” të z. E. B., në cilësinë e përgjegjësit të rojave të policisë private të firmës “{\*\*\*}”, në objektin e ish-fabrikës së tullave, në fshatin {\*\*\*}, Vorë. Në këtë procesverbal, z. E. B. rezulton të ketë deklaruar se: “[...] në këtë vend pune, unë kam rreth 1 vit e gjysëm dhe aktualisht kam për detyrë të kontrolloj rojet e turnit tim që aktualisht sot ishte turni i parë dhe dytë [...]”; (iii) me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2021, me lëndë “Shpjegime për pagesën e punonjësit E. B., për periudhën janar 2004 deri më 31 tetor 2007”, lëshuar nga administratori i shërbimit privat të sigurisë fizike “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën jepet informacion mbi pagesat mujore të punonjësit E. B., paga për vend pune, shpenzime udhëtimi, pagesa për punë jashtë orarit, apo dieta shërbimi jashtë rrethit, duke përcaktuar se shuma totale e të ardhurave të paguara për periudhën janar 2004 deri më 31 tetor 2007, është 1.020.000 lekë.

26.6.2. Nëpërmjet përgjigjeve të këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit sqaron se, vetëm me dërgimin e pyetësorëve, është vënë në dijeni të faktit që për punësimin e babait nuk ishin paguar tatimet përkatëse nga administratori i shoqërisë dhe se, nga komunikimi me të, është informuar se mosshlyerja e detyrimeve tatimore ka ndodhur për faktin se, ndërkohë që punonte, babai përfitonte pension kalimtar pleqërie si ushtarak dhe nuk lejohej sigurimi i dyfishtë, sikundër dhe aktualisht. Duke qenë se babai ka pengesë ligjore për të paguar si punëmarrës detyrimet tatimore, subjekti i rivlerësimit shprehet se administratori i shoqërisë është treguar i gatshëm të ndërmarrë çdo veprim për të deklaruar dhe paguar me vonesë detyrimet e mësipërme, pasi të ketë komunikuar me organet tatimore. Të njëjtin pretendim, subjekti i rivlerësimit mban edhe për të ardhurat nga punësimi i nënës

në sektorin privat, si sa i përket mosdijenisë se për këtë punësim nuk ishin paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet përkatëse, ashtu edhe pamundësisë për t'i paguar ato me vonesë si punëmarrëse, apo për shkak të emigrimit në Kanada të punëdhënësit, shtetasit B. P.

**26.6.3.** Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit të datës 25.06.2021, subjekti i rivlerësimit sqaron se, më datë 16.07.2006, pas lindjes së vajzës A. B., për shkak të rritjes të numrit të anëtarëve të familjes dhe hapësirës së ngushtë për të jetuar, më datë 16.08.2007, babai bleu apartamentin me sipërfaqe 53 m,<sup>2</sup> ngjitur me apartamentin ekzistues të tyre, të blerë në vitin 2001. Pavarësisht blerjes së apartamentit, sërish kanë jetuar si një familje, me kryefamiljar dhe administrues së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve, babain e subjektit të rivlerësimit. Mbi pronësinë e apartamentit, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk është bashkëpronar në të, blerja e të cilit është bërë nga babai. Subjekti i rivlerësimit shprehet se, ashtu si dhe prindërit, edhe ai ka kontribuar konsiderueshëm nga ana financiare me të ardhurat e deklaruara, në kuadër të bashkëjetesës në një familje me ta, por kontributi nuk e bën bashkëpronar të kësaj prone. Ai sqaron se ka dorëzuar të ardhurat te babai në cilësinë e kryefamiljarit, për shkak të traditës familjare, ndërkohë që deklaroi se nuk ka pasur dijeni për mënyrën e menaxhimit të tyre, masën e shpenzuar apo atë të kursyer nga babai.

**26.7.** Lidhur me shumën 20.000 euro, të depozituar në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se për këtë transaksion dhe qëllimin e tij, është vënë në dijeni nëpërmjet pyetësorit të Komisionit. Nga komunikimi me babain është informuar se kjo shumë përbën kursimet familjare të mbajtura fizikisht në banesë, të krijuara pas shpërnguljes në Tiranë në vitin 2001 deri në vitin 2007, të cilat më pas janë përdorur për blerjen e apartamentit më datë 16.08.2007, ngjitur me apartamentin e blerë po nga babai, më datë 04.08.2001. Kjo shumë sipas subjektit të rivlerësimit është krijuar me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, të shpjguara edhe në përgjigjet e pyetësorëve për blerjen e apartamentit më datë 16.08.2007. Në këto kushte, si dhe mospasja dijeni për të, shumën nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore si kursime. Pavarësisht se në një certifikatë familjare me prindërit, subjekti i rivlerësimit shprehet se ka qenë babai disponuesi i kësaj gjendje monetare fizike, si dhe ka qenë ai personi që ka çelur llogarinë bankare më datë 07.05.2007, e ka mbyllur më datë 13.08.2007, dhe nuk ka pasur detyrimin për t'i deklaruar këto fakte në deklaratat periodike vjetore, si në cilësinë e subjektit deklarues, ashtu edhe në cilësinë e personit të lidhur. Ndërsa, në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk është deklaruar llogaria bankare në shumën 20.000 euro dhe burimet e krijimit të saj, pasi në momentin e përpilimit të kësaj deklarate, depozita në fjalë ishte mbyllur, nuk ekzistonte, dhe në referim të neneve, nuk ishte detyrim deklarimi i saj.

**26.8.** Në rezultatet e hetimit administrativ, nisur nga fakti që babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin të deklarojë kursimet e tij në deklaratat periodike vjetore që subjekti ka depozituar në vite në ILDKPKI, Komisioni ka analizuar mundësitë financiare vetëm të prindërve të subjektit të rivlerësimit për kursimin e shumës 20.000 euro, nga viti 2001 deri në maj 2007, me të ardhura nga pensionet e tyre, pasi për punësimin në sektorin privat nuk rezultoi të ishin paguar detyrimet tatimore. Rezultati i Komisionit tregoi balancë negative në vlerën (-) 2.270.360 lekë për krijimin e depozitës 20.000 euro. Ndërsa sa i përket krijimit të apartamentit më datë 16.08.2007, duke mbajtur në konsideratë fakte të tilla si: (i) subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar kursime *cash* ndër vite; (ii) nuk kishte qartësuar masën e kontributit të tij në vlerën totale të apartamentit; (iii) kishte deklaruar apartamentin në deklaratën periodike vjetore dhe atë *vetting*, (iv) e ka poseduar këtë apartament me familjen ndër vite, si dhe (v) ka qenë në një përbërje familjare me prindërit gjatë viteve të deklarimit

dhe blerjes së pasurisë, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.01.2007 – 16.08.2007. Nga analiza e kryer për këtë periudhë, përfshirë blerjen e apartamentit, familja e subjektit të rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.043.447 lekë. Për këto dy balanca negative, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

**26.9.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me burimin e krijimit të shumës 20.000 euro dhe apartamentit me sipërfaqe 53,03 m<sup>2</sup>, subjekti i rivlerësimit prapësoi si përllogaritjen e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre, ashtu edhe metodologjinë e përdorur nga Komisioni në analizën e kryer. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e prindërve nga pensioni, të cilat janë pothuajse sa vlera e shpenzimeve jetike të përllogaritura për këtë periudhë, ndërkohë që për krijimin e depozitës duhet të merren në konsideratë edhe të ardhurat e tij nga pagat në funksionin e prokurorit, për periudhën 2001 – 2007, pasi babai si kryefamiljar ka menaxhuar të gjithë ekonominë e shtëpisë. Në vitet 2001 – mars 2005, subjekti i rivlerësimit sqaron se paga është marrë *cash* dhe pjesa më e madhe është depozituar në familje, vetëm një pjesë e vogël mbahej prej tij për mbulimin e shpenzimeve personale. Babai në menaxhimin e të ardhurave familjare i ka shpjeguar se pensionet e tyre kurseheshin dhe, me të ardhurat nga paga e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, mbulohehin të gjitha shpenzimet familjare. Nga viti 2005, sqaron subjekti, ka dorëzuar një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave dhe një pjesë e linte gjendje në llogarinë personale. Për këtë arsye, nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratat periodike vjetore 2003 – 2006, pasi kjo gjendje nuk disponohej nga subjekti i rivlerësimit por nga babai, një pjesë ishte kursyer nga të ardhurat nga pensioni dhe pjesa tjetër nga të ardhurat e realizuara nga punësimi i prindërve në sektorin privat. Në shumën e kursyer nga babai, subjekti i rivlerësimit është i mendimit se ka shërbyer dhe kontributi i tij.

**26.10.** Në vijim të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit i referohet nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në kuptim të të cilit, prindërit nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë e tyre dhe subjekti në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar vetëm të ardhurat e tij nga pagat. Për sa më sipër dhe në kushtet kur ai ka jetuar gjatë gjithë kohës me prindërit, Komisioni duhet të kryejë analizën financiare për mundësinë e depozitimit të shumës 20.000 euro, jo vetëm duke përfshirë të ardhurat nga pensioni i prindërve, por edhe kontributin nga të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të konsiderohen me burime të ligjshme, të ardhurat nga pagat e babait, në shoqëritë e ruajtjes fizike “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, si dhe të ardhurat e nënës nga punësimi pranë personit fizik “{\*\*\*}”. Në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, këto konsiderohen të ardhura të ligjshme në respekt të dispozitave ligjore<sup>30</sup>, që rregullojnë marrëdhënien e punës, shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat dhe pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi nëpërmjet tyre ligjvënësi ka përcaktuar se është punëdhënësi, i cili mban dhe derdh tatimin mbi të ardhurat personale, si dhe

---

<sup>30</sup> *Shih nenet 109, 110, 117 dhe 121 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 6 dhe 8 të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 10, paragrafi 2, të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 8/a dhe 14, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.6.1 e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, i Ministrisë së Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat, i dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nenin 177, pika 3 e ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

përcakton përgjegjësinë në rast të kundërvajtjeve administrative që lidhen me shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit sqaron se babai i tij nuk mund të paguajë personalisht tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas periudhave të marrëdhënies së punës, por është punëdhënësi ai që ka detyrimin për deklarimin, evidentimin, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve, si për tatimin mbi të ardhurat personale, ashtu dhe të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore. Po në kuadër të detyrimit tatimor, sipas subjektit të rivlerësimit, vetë legjislacioni tatimor lejon pagimin e tatimit mbi të ardhurat në një kohë të mëvonshme, duke i shndërruar ato në të ligjshme, apo detyrimet tatimore të papaguara mund të falen me ligj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 155 të saj, ligji nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në nenin 33, dhe ligji nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5, parashikojnë qartësisht procedurën që ndiqet mbi pagesën e detyrimeve tatimore. Mënyra e pagesës apo e mbledhjes së tatimit mbi të ardhurat, nuk mund të ndryshohet me marrëveshje të palëve, pasi Kushtetuta nuk e lejon një veprim të tillë. Në këto kushte, babai nuk mund të ketë përgjegjësi dhe të penalizohet për shkak se punëdhënësi nuk i ka paguar sigurimet shoqërore, madje në këtë aspekt, ai është i dëmtuar.

**26.11.** Lidhur me mosdeklarimin e kursimeve *cash* ndër vite, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se ai ka dhënë pagën në familje, duke hequr normalisht vetëm një pjesë të saj për përballimin e shpenzimeve personale. Gjendjen e *cash*-it nuk e ka disponuar ai, por babai si kryefamiljar, i cili menaxhonte ekonominë e familjes. Mosdetyrimi i prindërve për deklarimet periodike vjetore dhe deklarimi i tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ka sjellë edhe këtë konfuzion për kursimet *cash* ndër vite. Kontributi nga paga e subjektit të rivlerësimit ka shërbyer për përballimin e shpenzimeve jetike dhe kursimin nga prindërit të pensioneve të tyre.

**26.12.** Lidhur me qartësimin e kontributit në vlerën totale të blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kontributi i tij ka qenë: (i) në pjesën më të madhe, shuma 1.650.000 lekë, e tërhequr nga “Raiffeisen Bank” ShA, më 13.08.2007, krijuar me të ardhurat nga pagat në funksionin e prokurorit, si dhe (ii) në krijimin e kursimeve *cash* nga babai, në shumën 20.000 euro, depozituar në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA. Për sa kohë kursimet janë mbajtur nga babai, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk mund të përcaktojë saktësisht sa ka qenë kontributi i tij në krijimin e kursimeve *cash*, pasi ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe ka munguar detyrimi për deklarimin e tyre ndër vite. Apartamenti është deklaruar si në deklaratën periodike të vitit 2007, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, pikërisht për faktin e kontributit të konsiderueshëm në krijimin e tij, i cili nuk e bën atë bashkëpronar, ashtu edhe për faktin se e ka poseduar që prej fillimit këtë apartament, duke investuar për të përshtatur ambientet e tij. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, pasi sipas tij, analiza nuk duhet të verifikojë mundësinë financiare të tij dhe të prindërve vetëm për periudhën 1 janar – 16 gusht 2007, por edhe periudhën më përpara, duke qenë se rezulton e provuar që babai ka pasur kursime *cash*, të cilat janë depozituar në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA. Sipas subjektit të rivlerësimit ka qenë pikërisht pjesa më e madhe e këtyre kursimeve të depozituara, së bashku me shumën e tërhequr nga subjekti në “Raiffeisen Bank” ShA, si burime për blerjen e pasurisë “Apartament”, me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>. Depozitimi i kursimeve *cash* në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA tregon ekzistencën e tyre dhe duhet të vlerësohet nga Komisioni duke mbajtur një qëndrim garantist ndaj subjektit të rivlerësimit. Nëse në analizën financiare 01.01.2007 – 16.08.2007, për blerjen e apartamentit, do të përfshihej pakësimi i gjendjes *cash*, që minimalisht ka qenë 1.428.060

lekë, sa vlera e pensioneve përfituar nga prindërit për periudhën 2001 – maj 2007, rezultatet e saj do të tregonin balancë pozitive në shumën 133.437 lekë.

**26.13.** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se, për të verifikuar mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e shumës 20.000 euro deri më datë 07.05.2007, Komisioni ka kryer analizën financiare duke përfshirë në zërin “Të ardhura”, të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2001 – 2002 (periudhë në të cilin nuk ekzistonte detyrimi për deklaram) dhe të ardhurat e prindërve provuar me dokumentacion, për periudhën 2001 – prill 2007, ndërsa në zërin “Shpenzime” ka përlogaritur shpenzime jetike për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e tij në periudhat respektive. Diferenca negative në vlerën (-) 1.758.785 lekë, e rezultuar nga kjo analizë, ka treguar pamundësi financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe vetë atij, për krijimin e depozitës 20.000 euro me burime të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar si rrjedhojë, në pamjaftueshmëri financiare edhe për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, më datë 16.08.2007.

**26.14.** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë dhe ligjor për punësimin e nënës në sektorin privat dhe të babait deri në vitin 2004 në të njëjtin sektor, Komisioni me të padrejtë nuk ka konsideruar kërkesën e tij për të përfshirë në analizën financiare si burime të ligjshme të paktën të ardhurat e përfituara nga puna e babait në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, gjatë periudhës 2004 – 2007, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se legjitimitimin e një të ardhure për ta konsideruar burim të ligjshëm, neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ia ka atribuar pagesës së detyrimit tatimor mbi të. Në rastin konkret, edhe pse subjekti i rivlerësimit duket se ka provuar punësimin e babait pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përsëri të ardhurat e krijuara nuk kënaqin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t’u konsideruar të ligjshme dhe për t’u përfshirë në analizë.

**26.15.** Lidhur me metodën e kryerjes së analizës financiare nga Komisioni, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ndodhet në një certifikatë familjare me prindërit, jeton me ta në një ekonomi të përbashkët familjare, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerëson që verifikimi i mundësisë financiare për krijimin e depozitës 20.000 euro, në maj 2007, dhe blerjen e apartamentit në gusht të po këtij viti, të bëhet në kuadër të regjimit të përbashkët familjar dhe jo e ndarë veçmas, për subjektin e rivlerësimit nga prindërit e tij. Në vijim të arsytimit, në paragrafin 17.4 të këtij vendimi, me konsideratë qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit në ankim, Kolegji, duke mbajtur një qëndrim garantist, kontrollloi analizën e kryer nga ana e Komisionit për të provuar mundësinë financiare të babait në cilësinë e kryefamiljarit, për të krijuar depozitën në shumën 20.000 euro, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, më datë 07.05.2007, dhe blerjen e apartamentit më datë 16.08.2007, duke verifikuar mundësinë kumulative të tyre për të kursyer gjatë periudhës 05.08.2001 (një ditë pas blerjes nga babai i subjektit të rivlerësimit të apartamentit 91.93 m<sup>2</sup>) deri në datat e krijimit të pasurive respektive, cituar më sipër. Rezultatet e analizës financiare treguan një balancë pozitive dhe, në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kishin mundësi të krijojnë këto pasuri me të ardhurat e tyre nga burime të ligjshme.

*Për automjetin tip "Mercedes Benz", blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.07.2011, në Gjermani*

27. Komisioni, në konkluzionin përfundimtar për këtë pasuri, vlerësoi se, edhe pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën mbi pamundësinë financiare, me burime të ligjshme, për blerjen e këtij automjeti. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë "Automjet", në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të shkronjës "b", pika 5 e nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
28. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se balanca negative për krijimin e kësaj pasurie vjen si rrjedhojë: (i) e mosmarrjes në konsideratë të kursimeve *cash* që prindërit kishin mundësi t'i kursenin deri në fund të vitit 2010, ndërkohë që nuk kanë pasur detyrimin për deklarimin e tyre sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, (ii) Komisioni duhet të përfshinte të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën janar – korrik 2011 dhe ndërkohë analiza për mundësinë e kursimit të prindërve të bëhej e ndarë në disa periudha, për faktin se kjo mundësi nuk mund të zerohet, për sa kohë ata nuk kanë qenë subjekte deklaruese; (iii) mjaftonte që Komisioni të përfshinte në analizën financiare pakësimin me 500.000 lekë të kursimeve *cash* të prindërve (shumë që përfaqëson dhe vlerën e pensioneve të tyre në një vit), për të rezultuar me mundësi financiare për të përballuar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit. Për më tepër që analiza financiare e vitit 2010 ka rezultuar me balancë pozitive, në vlerën 1.129.438 lekë.
29. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të administruar në Komision, trupi gjykues konstaton se:
- 29.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: automjet e tipit "Mercedes Benz", lloji E220CDI, me targë {\*\*\*}, blerë më datë 25.07.2011, në Gjermani, në vlerën 12.000 euro dhe 1.000 euro, shpenzime udhëtimi. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga paga në funksionin e prokurorit; (ii) të ardhurat e përfituara prej babait nga pensioni i pleqërisë, pensioni suplementar, si dhe të ardhurat nga punësimi në sektorin privat; (iii) të ardhurat e përfituara prej nënës nga pensioni i pleqërisë; (iv) të ardhurat e bashkëshortes, prej punësimit si specialiste pranë Organizatës Joqeveritare Financiare "{\*\*\*}", përfshirë edhe të ardhurat e përfituara prej saj nga punësimi në sektorin privat; (v) hua e marrë më datë 20.07.2011, në shumën 3.000 euro, marrëveshje verbale, pa interes, me z. F. M.; (vi) hua e marrë më datë 20.07.2011, në shumën 2.000 euro, marrëveshje verbale, pa interes, me z. A. Ll.
- 29.2. Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë këtë automjet, por jo burimin e krijimit të tij, ndërkohë që në rubrikën "Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë", deklaroi dy huat e marra me qëllim blerjen e mjetit në Gjermani.
- 29.3. Referuar akteve të dosjes së mjetit, të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2019, automjeti rezulton se është blerë nga vetë subjekti i rivlerësimit më datë 25.07.2011, në vlerën 12.000 euro, nga shitësi "{\*\*\*}", në Gjermani. Sipas dokumentacionit të administruar, për këtë automjet janë shlyer detyrimet doganore më datë 12.07.2013, në shumën 342.673 lekë, dhe rezulton i regjistruar më datë 15.07.2013.
- 29.4. Pasi verifikoi dhe konstatoi se huadhënësit F. M. dhe A. Ll. kanë pasur mundësi financiare për të dhënë, më datë 20.07.2011, huat në shumën 3.000 euro dhe 2.000 euro përkatësisht, bazuar në dokumentacionin provues mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes dhe prindërve, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën janar – korrik 2011, duke qenë se në deklaratën periodike vjetore 2010, subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar kursime *cash*. Në



kushtet kur rezultatet e analizës financiare treguan mungesë të burimeve të tyre të ligjshme në shumën 471.642 lekë, duke mos justifikuar kështu blerjen e automjetit, Komisioni, me rezultatet e hetimit administrativ, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

**29.5.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat nga pensioni i prindërve për periudhën janar – korrik 2011 dhe jo kursimet *cash*, që ata kanë krijuar nga administrimi i ekonomisë familjare. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeja se përse ka deklaruar pensionet e prindërve si burim krijimi të pasurisë së luajtshme, ka qenë pikërisht fakti për të treguar se kanë kontribuar fillimisht edhe ata në blerjen e automjetit. Kursimet që mbante babai kanë qenë si nga pagat e subjektit, ashtu edhe nga pensionet e tyre. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se, në momentin e blerjes së automjetit, nuk kishte deklaruar kursime *cash* ndonjëherë, duke menduar se kjo mënyrë deklarimi mund të krijonte pasaktësi dhe, në deklaratën periodike vjetore 2011, ka deklaruar për herë të parë kursime *cash* në vlerën 300.000 lekë, ndërkohë që babai vazhdonte të mbante dhe dispononte kursimet *cash* të tij. Subjekti sqaron gjithashtu se, deri në vitin 2010, nuk ka deklaruar kursime *cash*, jo se nuk ka pasur kursime të tilla, por sepse ato administroheshin prej babait. Ndonëse në deklaratimet periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i qartë në analizimin e burimeve të krijimit sipas praktikës tashmë të konsoliduar, si nga Komisioni, ashtu edhe nga Kolegji, ai thekson se familja e tij ka pasur burime nga të ardhurat e tyre të ligjshme për shtimin e pasurisë “Automjet”, në vitin 2011.

**29.6.** Si gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ashtu edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizimin e mundësisë financiare të burimeve të ligjshme në momentin e krijimit të pasurisë, në rastet kur disa anëtarë janë subjekte deklaruese dhe disa anëtarë të tjerë të familjes nuk janë të tillë, krijon konfuzion dhe pasaktësi. Nga analiza financiare e kryer në Komision, për vitet 2009 dhe 2010, balancat kanë rezultuar pozitive, në shumën të konsiderueshme, dhe kursimet *cash* të babait deri në fund të vitit 2010, kanë qenë jo të vogla. Për rrjedhojë, analiza financiare duhet të përfshijë edhe kursimet *cash* që ka pasur babai deri në fund të vitit 2010, argument që mbështetet edhe nga deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën janë deklaruar si burim krijimi edhe të ardhurat nga pensionet e tyre, në kuptim të faktit se me kontributin e subjektit të rivlerësimit, babai përballonte shpenzimet familjare dhe prindërit vetë përpiqeshin të kursenin pensionet e tyre.

**29.7.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet të përfshinte në analizën financiare, të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit në periudhën janar – korrik 2011 dhe, ndërkohë, analiza për mundësinë e kursimit të prindërve të tij, të bëhej e ndarë në disa periudha, për vetë faktin se nuk mund të zerohet mundësia e kursimit të tyre, për sa kohë ata vetë nuk kanë qenë subjekte deklaruese. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare e kryer nga vetë Komisioni tregon balancë pozitive në vlerën 1.129.438 lekë, në fund të vitit 2010, dhe mjafton që në analizën financiare të përfshihet pakësimi me 500.000 lekë i kursimeve *cash* të prindërve (të cilët kanë pasur mundësi t’i kursejnë ato, në një vit, nga vlera e pensionit të tyre), subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mundësi financiare për të përballuar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, në vitin 2011.

**29.8.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit dhe në deklaratën periodike vjetore 2011, rezulton të ketë deklaruar: “*Kursime nga pagat, deklaruesi dhe bashkëshortja në periudhën 01.10.2011 deri më datë 01.03.2012, në vlerën 300.000 lekë*”, trupi gjykues i vlerëson këto të vetmet kursime për këtë vit të të gjithë familjes, pasi nuk mund të pretendohet ekonomi e përbashkët dhe kursime të ndara mes subjektit të rivlerësimit dhe prindërve

të tij. Nisur nga fakti që automjeti është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe ky i fundit nuk ka deklaruar, në deklaratën periodike vjetore 2011, burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, e për rrjedhojë, as kursimet *cash* të prindërve, ndërkohë që rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* të të gjithë familjes në vitet në vazhdim, e bën pretendimin e subjektit të rivlerësimit të pabazuar, e për këtë arsye, në kontrollin e analizës financiare të kryer në Kolegj, nuk janë përfshirë kursimet *cash* të prindërve në shumën 500.000 lekë, si burim i pretenduar për blerjen e automjetit. Ashtu si trajtuar edhe më sipër në këtë vendim, jurisprudenca<sup>31</sup> e Kolegjit, e sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, paraqet një situatë të ndryshme faktike nga ajo e subjektit të rivlerësimit.

**29.9.** Nga analizimi i deklarimeve në deklaratën periodike vjetore 2011, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit pasurinë “likuiditete në *cash*” të këtij viti nuk e ka deklaruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe orientimet e vetë formatit të deklaratës së interesave privatë, pra për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011, por deklaroi kursime *cash* në masën 300.000 lekë, për periudhën 01.10.2011 deri më 01.03.2012. Komisioni, në analizën e kryer për periudhën 01.01.2011 – 25.07.2011, në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit, ka përllogaritur  $\frac{1}{2}$  e kursimeve *cash*, 300.000 lekë (pra 150.000 lekë), ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë kursim *cash* (300.000 lekë) të krijuar në periudhën 01.10.2011 – 01.03.2012, pra pas blerjes së automjetit.

**29.10.** Për shkak të këtij interpretimi dhe përllogaritjeje të kursimeve *cash* nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të kryer në Komision, për pasurinë “Automjet” i markës “Mercedes Benz”, blerë më 25.07.2011, balanca negative në shumën 471.642 lekë e konstatuar nga Komisioni u reduktua në (-) 323.108 lekë dhe subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie dhe shpenzimet e kryera për periudhën e analizuar, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Për llogarinë bankare në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, në emër të babait të subjektit, çelur në datën 30.07.2014*

- 30.** Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundimin se babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b”, pika 5 e nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- 31.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke e konsideruar në interpretim të gabuar të rrethanave dhe fakteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, me pretendimet se: (i) nëse në analizë financiare do të ishin përfshirë kursimet *cash* të akumuluar në vitet 2010-2011 nga prindërit, që përdorshin herë pas here për nevojat familjare, mundësia për krijimin e depozitës do të rezultonte pozitive; (ii) subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, i ka kërkuar Komisionit korrektimin e shpenzimeve jetike për djalin, në vitet 2011 dhe 2012, për shkak të moshës së tij, si dhe përllogaritjen e shpenzimeve jetike në vitin 2013 për vajzën, në masën sa  $\frac{1}{3}$  e shpenzimeve jetike për person, pasi në pagesën e shkollës përfshiheshin dhe dy vakte.
- 32.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore administruar në Komision, trupi gjykues konstaton se:

**32.1.** Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *llogari bankare në “Banka*

---

<sup>31</sup> *Shih vendimin (JR) nr. 20, datë 03.05.2023, paragrafët 11.4 – 11.10, që i përket subjektit të rivlerësimit B. M., vendimi (JR) nr. 26, datë 03.07.2023, paragrafi 14.10, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. G. Xh.*

*Kombëtare Tregtare*” ShA, në emër të babait, me numër {\*\*\*}, çelur më datë 30.07.2014, në shumën “12.980 euro”, me pjesë takuese “bashkëpronësi sipas certifikatës familjare”. Burimi i krijimit deklarohet: nga të ardhurat si prokuror të subjektit të rivlerësimit; nga pensioni i pleqërisë së prindërve; si dhe nga punësimi i bashkëshortes në sektorin privat dhe më pas në sektorin shtetëror.

Në deklaratën periodike vjetore 2014, subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë llogari bankare: “në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë të familjes”. Si burim krijim deklaroi të kenë shërbyer kursimet e realizuara nga pagat e tij, të bashkëshortes, pensionet e prindërve gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014. Po në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursimet e realizuara nga pagat e tij, të bashkëshortes, pensionet e prindërve në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2014, të cilat nuk janë depozituar në sistemin bankar, në shumën “450.000 lekë”.

32.2. “Banka Kombëtare Tregtare” ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2019, ka konfirmuar depozitën bankare në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. E. B., në vlerën 12.980 euro, me afat 1 (një) muaj, automatikisht e rinovueshme, me status aktiv.

32.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se, nga analiza financiare e kryer për vitet 2011 – 2014, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të krijuar kursimet *cash* me burime të ligjshme për vitet 2012 dhe 2013, në shumën totale (-) 577.176 lekë, për rrjedhojë ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës bankare në shumën 12.980 euro, më datë 30.07.2014. Në lidhje me këtë pamjaftueshmëri financiare, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

32.4. Në prapësimet mbi këto rezultate hetimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shpjeguar dhe i ka kërkuar Komisionit që në analizën financiare duheshin korrigtuar shpenzimet jetike për vitet 2012 dhe 2013. Sipas subjektit të rivlerësimit, djali i ka lindur në datën 25.10.2011 dhe Komisioni nuk ka përfshirë shpenzime jetike për të në vitin 2011, por i ka përfshirë ato në vitin 2012. Duke qenë se shpenzimet për fëmijën kanë qenë të pakta, subjekti i rivlerësimit pretendon që, sipas analizës financiare të kryer prej tij, nëse për vitin 2012 shpenzimet jetike korrigjohen në shumën 117.520 lekë më pak, atëherë balanca negative do të reduktohej në (-) 268.882 lekë. Për analizën financiare të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar korrigjimin e shpenzimeve jetike, pasi vajza e kishte të përfshirë në pagesën e shkollës, mëngjesin, drekën dhe pasditen. Shpenzimet jetike të vajzës, nuk mund të jenë sa ato për një person në kushtet kur pjesën më të madhe të kohës e kalon në shkollë. Nëse në analizën financiare të këtij viti, shpenzimet jetike për vajzën do të përlllogariteshin sa 1/3 e shpenzimeve jetike për një person, pasi dy vakte i ofrohen nga shkolla kundrejt pagesës së kryer për të, atëherë do të kishim një korrigjim në ulje të shpenzimeve jetike për këtë vit në shumën (-) 94.016 lekë dhe pamundësia për vitin 2013, do të reduktohej në (-) 96.758 lekë.

32.5. Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit shprehet se organet e rivlerësimit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës referohen në shkresën e ILDKPKI-së së datës 04.03.2019, e cila në vetvete bazohet në të dhënat statistikore të INSTAT<sup>32</sup>-it për buxhetin e familjes, të rezultuara nga anketa statistikore. Në tabelat statistikore që ky institucion ka vënë në dispozicion të përdoruesve, në zërin “shpenzime jetese” përfshin: “ushqim dhe pije joalkoolike, pije alkoolike, duhan, veshje dhe këpucë, shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar, mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës, shëndet, transport, komunikim, argëtim dhe kulturë, arsim, restorante dhe hotele, të tjera mallra dhe shërbime”. Në kuadër të këtij arsytimi, sipas subjektit të

<sup>32</sup> Akronim për Institutin e Statistikave.

rivlerësimit, të paktën një pjesë e shpenzimeve të kryera për pagesën e shkollës janë të përfshira në shpenzimet jetike sipas INSTAT-it.

**32.6.** Subjekti i rivlerësimit thekson gjithashtu, se prindërit nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për këtë arsye, kursimet e tyre nuk janë deklaruar çdo vit. Nëse në analizën financiare të kryer për pasurinë “depozitë në llogarinë bankare të babait”, përfshihen dhe kursimet *cash* të akumuluar në vitet 2010-2011 nga prindërit, diferenca do të rezultonte pozitive. Diferencat e konstatuara nga Komisioni në këtë pikë mbulohen nga kursimet *cash* të prindërve, të cilat përdoren herë pas here për nevojat familjare, por pavarësisht këtij fakti diferencat negative të konstatuara, bazuar në parimin e proporcionalitetit, janë të tilla që nuk mund të konkludohet pamjaftueshmëri.

**32.7.** Lidhur me shpenzimet jetike, Komisioni në vendim ka arsyetuar se: “[...] nisur nga standardet e krijuara për aplikimin e të dhënave minimale të kostos së jetesës, sipas INSTAT-it - pavarësisht moshës së anëtarëve të familjes dhe/ose frekuentimit të shkollave apo kopshteve. Shpenzimet e jetesës nuk mund të zbriten nga analiza financiare, pasi shpenzimet e arsimimit privat nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në kushtet kur ky shërbim në Republikën e Shqipërisë ofrohet me shpenzime modeste nga institucionet publike, i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i. Shpenzimet bazike që përllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme, që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit, si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Gjithashtu, edhe nga sa është arsyetuar më sipër mbi pamundësinë e konsiderimit dhe përfshirjes në analizë financiare të kursimeve hipotetike *cash* të familjes së subjektit të padeklaruara ndonjëherë, nuk evidenton elemente që mund të ndryshojnë rezultatin e arritur në fund të hetimit administrativ, sikurse i është njoftuar subjektit”.

**32.8.** Për sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shpenzimet jetike të djalit, trupi gjykues vlerëson të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi, duke qenë se shpenzimet jetike përllogariten sipas të dhënave të tabelës përmbledhëse të konsumit për frymë sipas INSTAT-it<sup>33</sup>, për vitet 2003 – 2016, i cili në metodologjinë statistikore të përdorur për përllogaritjen e këtyre shpenzimeve, i kategorizon ato në pesë grupe, “për frymë”, “për dy, tre, katër dhe pesë familjarë”. Në këto kushte, në kuadër të të dhënave që mundëson INSTAT, institucionet e rivlerësimit mund të përllogarisin shpenzime jetike për frymë apo familje dhe jo sipas grupmohave.

**32.9.** Lidhur me pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se shpenzimet jetike për vajzën në vitin 2013, duhet të përllogariteshin sa 1/3 e shpenzimeve jetike për person, duke qenë se dy vakte ushqimi i ofrohen nga shkolla kundrejt pagesës së kryer për to, me pasojë korrigjimin në ulje të shpenzimeve jetike totale të këtij viti në vlerën (-) 94.016 lekë, dhe reduktimit të mungesës financiare për vitin 2013 në (-) 96,758 lekë, trupi gjykues konstaton se, nga vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 04.06.2021, i shkollës anglo-shqiptare “{\*\*\*}”<sup>34</sup>, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, më datë 07.06.2021, në Komision, përveç shumave të paguara për secilin vit të periudhës 2012 – 2020, për

<sup>33</sup> Përcjellë Kolegjit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019.

<sup>34</sup> Referuar vërtetimit, pagesat e tarifës së shkollës nga viti 2012 deri në vitin 2020 janë si vijon: “për vitin 2012, shuma e paguar 140.250 lekë; për vitin 2013, shuma e paguar 346.500 lekë; për vitin 2014, shuma e paguar 345.250 lekë; për vitin 2015, shuma 346.000 lekë; për vitin 2016, shuma e paguar 352.000 lekë; për vitin 2017, shuma e paguar 328.500 lekë [...]”.

nxënësen A. B., nuk evidentohen pagesa të kryera pikërisht për ushqim, apo të specifikohet që në pagesat e kryera janë përfshirë edhe kostot e ushqimit. Ndërsa në vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2024, “Për pagesën e shkollës për A. A. B., për periudhën 2012-2016”, lëshuar nga shkolla anglo-shqiptare “{\*\*\*}”, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet me shkrim, ndonëse se ky vërtetim nuk u administrua nga Kolegji në cilësinë e provës, në të konfirmohet shuma totale e paguar çdo vit arsimor, e cila përfshin pagesën e tarifës së shkollës (përfshirë ushqimin), si dhe transportin, por përsëri nuk gjen pasqyrim një informacion që të ndajë tarifën e shkollimit nga ajo për ushqim, pra nuk dokumentohen vlerat e paguara për ushqimin e vajzës, që të mund të reflektohen në analizë. Për më tepër, kur vetë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë përlllogaritje analitike të këtyre kostove, ku të specifikoheshin ditë mësimi, pushime semestrale, vjetore etj., për të mundësuar ndonjë përlllogaritje alternative dhe justifikuar reduktimin e shpenzimeve jetike në shumën e pretenduar. Sikurse dhe vetë subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ dhe ankim, edhe nëse korrektohen shpenzimet jetike për kostot e ushqimit të vajzës, përsëri rezultati i vitit financiar është negativ.

**32.10.** Në kushtet kur në deklaratën periodike vjetore 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi të depozitës bankare në shumën 12.980 euro, kursimet e realizuara nga paga e tij, e bashkëshortes, pensionet e prindërve gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e kursimeve *cash* të akumuluar në vitet 2010-2011 nga prindërit, që përdorshin herë pas here për nevojat familjare, gjendet i pabazuar.

**32.11.** Nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit për burimin e krijimit të depozitës bankare, Komisioni verifikoi mundësinë financiare për kursim të familjes së subjektit për këto vite. Nga analizimi i vendimit<sup>35</sup> të Komisionit për periudhën 2011 – 2014, në raport me leximin e deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton disa pasaktësi, si vijon:

**32.11.1.** Komisioni, në përshkrimin që u ka bërë në vijim të paragrafit 5.2. të vendimit objekt shqyrtimi, kursimeve *cash* deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2011, citon: “*kursime nga 1 janar – 31 mars 2012, në shumën 300.000 lekë*”, ndërkohë që nga leximi i kujdesshëm i deklaratës, rezulton e deklaruar: *kursime për periudhën 01.10.2011 deri më 01.03.2012, në shumën 300.000 lekë*. Pra, këto kursime i përkasin periudhës tetor 2011 – 1 mars 2012 dhe jo janar 2011 – 31 mars 2012, sikurse i ka konsideruar Komisioni.

**32.11.2.** Për vitin 2012, Komisioni në vendim e konsideron vlerën e kursimeve *cash* 1.200.000 lekë, ndërkohë që nga leximi i deklaratës periodike vjetore 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi: (i) shtim të pasurisë së luajtshme nga shitja e një autoveture të markës “Benz” 190, më datë 01.08.2012, në vlerën 2.500 euro; (ii) pakësim të pasurisë së luajtshme nga blerja e automjetit “Volkswagen”, më datë 17.08.2012, në vlerën 4.000 euro, për të cilën deklaroi të kenë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit më datë 01.08.2012, si dhe kursimet e realizuara gjatë viteve 2011 – 2012; (iii) shtim të pasurisë së luajtshme nga kursimet e realizuara nga pagat e deklaruesit, të bashkëshortes, pensionet e prindërve në periudhën 01.03.2012 deri më datë 01.03.2013, në vlerën 900.000 lekë.

**32.12.** Në kushtet kur ka deklaruar se ka paguar shumën 4.000 euro për blerjen e automjetit “Volkswagen” duke përdorur 2.500 euro nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” (të cilat Komisioni i ka konsideruar në vlerën e blerjes së automjetit në datën 31.05.2004, 250.000 lekë) dhe kursimet e krijuara në periudhën 01.10.2011 deri më 31.03.2012, kursimet e familjes së subjektit të rivlerësimit për vitin 2012 kanë qenë 900.000 lekë, të deklaruara të shtuara nga subjekti i rivlerësimit në

<sup>35</sup> Shih tabelën e parë në faqen 28 të vendimit nr. 469, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

deklaratën periodike të këtij viti, e në këto kushte gjendja *cash* në fund të vitit 2012 nuk duhet konsideruar 1.200.000 lekë sa përlllogaritur nga Komisioni (300.000 lekë + 900.000 lekë).

**32.13.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003 për vitet 2011 dhe 2012, duke njohur vlerën provuese që ligji nr. 84/2016 u ka dhënë deklaratave periodike vjetore në nenin 32, pika 5 e tij, trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor korrektoi analizën financiare të Komisionit në këtë drejtim. Balancat e analizës financiare pas këtij korrigjimi treguan se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë: (i) me mundësi për kursimin e vlerës 300.000 lekë në periudhën 01.10.2011 – 01.03.2012; (ii) me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 206.080 lekë, për krijimin e kursimeve të deklaruara në vlerën 900.000 lekë, për periudhën 02.03.2012 – 01.03.2013; (iii) me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 203.122 lekë, për krijimin e kursimeve të deklaruara në vlerën 600.000 lekë, për periudhën 02.03.2012 – 31.12.2013; (iv) me mundësi financiare për të kursyer shumën 398.834 lekë për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014.

**32.14.** Për sa arsyetuar më sipër, kontrolli në Kolegj i analizës financiare të kryer nga Komisioni, për krijimin e depozitës në vlerën 12.980 euro, çelur në datën 30.07.2014, në “Bankën Kombëtare Tregtare” ShA, në emër të babait, tregoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 409.202 lekë, për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, si dhe shpenzimet e kryera për periudhën nën analizë 01.10.2011 – 30.07.2014, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me gjendjen cash në banesë, në shumën 1.300.000 lekë, në vitin 2015*

**33.** Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**34.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke e konsideruar atë në interpretim të gabuar të rrethanave dhe fakteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, me pretendimin se, nëse në analizën financiare, shpenzimet jetike për vajzën do të përlllogariteshin sa 1/3 e shpenzimeve jetike për person, pasi dy vakte i kalon në shkollë, atëherë do të kishte korrigjim në ulje të shpenzimeve jetike për këtë vit në shumën (-) 94.016 lekë dhe pamundësia financiare për vitin 2015 do të reduktohej në (-) 230.379 lekë.

**35.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se:

**35.1.** Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Gjendje fizike të vlerave monetare, të padepozituara në sistemin bankar, të cilat aktualisht mbahen në banesë, në vlerën 1.300.000 lekë, me pjesë takuese në bashkëpronësi sipas certifikatës familjare*”.

**35.2.** Në deklaratën periodike vjetore 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Kursime të realizuara nga pagat e subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes, pensionet e prindërve gjatë vitit 2015, duke përfshirë dhe shumën 450.000 lekë kursime deri në fund të vitit 2014. Shuma e treguar në rubrikën përkatëse është gjendja fizike e lekëve në disponim. Kursimet janë në lekë fizike dhe nuk janë depozituar në sistemin bankar. Vlera 1.300.000 lekë, në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë të familjes*”.

**35.3.** Referuar deklaratimeve periodike të kursimeve *cash*, për vitet 2014 dhe 2015, Komisioni në

rezultatet e hetimit administrativ konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mjaftueshmëri financiare për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 450.000 lekë, të deklaruara në vitin 2014, dhe pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 324.395 lekë për të justifikuar shtesën e gjendjes së likuiditeteve *cash në banesë*, deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

35.4. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me pamjaftueshmërinë e vitit 2015 në shumën 324.395 lekë, subjekti i rivlerësimit vlerësoi se, edhe në këtë vit, duhet të korrighohen në ulje shpenzimet jetike për vajzën. Pagesa e shkollës, sipas tij, përfshin në çmim edhe vaktet ushqimore të cilat konsumohen në shkollë dhe në analizën financiare do të thotë ngarkim i shpenzimeve jetike dy herë, në masën takuese që shpenzimet e tarifës së shkollimit përfshijnë edhe ushqimin. Përveç sa më sipër, diferencat negative të konstatuara duhet të vlerësohen në dritën e parimit të proporcionalitetit, duke përmendur qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën<sup>36</sup> e tij. Diferencat e konstatuara nga Komisioni në këtë pikë mbulohen nga kursimet *cash* të prindërve, të cilat përdorshin herë pas here për nevojat familjare, por pavarësisht këtij fakti, këto diferenca, bazuar në parimin e proporcionalitetit janë të tilla që nuk mund të konkludohet për pamjaftueshmëri.

35.5. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, duke përdorur të njëjtin arsyetim si në paragrafin 32.9 të këtij vendimi, sa i përket shpenzimeve jetike të vajzës, si dhe në kushtet kur kursimet e prindërve kanë shërbyer për krijimin e depozitës 12.980 euro, më datë 30.07.2014, dhe kursimet në shumën 450.000 lekë, të realizuara deri në fund të këtij viti, janë konsideruar si burim krijimi të shumës 1.300.000 lekë, e bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përdorim të kursimeve të prindërve, në kushtet kur për krijimin e të gjitha këtyre pasurive, analiza është kryer në kuadër të regjimit të përbashkët familjar. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vitin 2015, në vlerën (-) 318.396 lekë, për krijimin e gjendjes *cash* në banesë në shumën 1.300.000 lekë dhe mbulimin e shpenzimeve, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

36. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim, se diferencat negative jo të konsiderueshme sa i përket krijimit të pasurive automjet “Mercedes Benz”, depozitë bankare “12.980 euro”, dhe gjendje *cash* “1.300.000 lekë”, në fund të vitit 2015, e pandryshuar në fund të vitit 2016, duhen vlerësuar në frymën e parimit të proporcionalitetit, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëritë e konstatuara për këto pasuri, vlerësuar së bashku me konkluzionin për shumën 32.000 USD të depozituar *cash* nga babai në llogarinë bankare të tij, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, e bëjnë të pazbatueshëm këtë parim.
37. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çmon se vendimi nr. 469, datë 01.11.2021, i Komisionit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

---

<sup>36</sup> Shih vendimin (JR) nr. 31, datë 18.11.2020, pika 36, paragrafi i fundit dhe vendimin (JR) nr. 11, datë 31.03.2021, paragrafi 23.4, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përkasin respektivisht subjektit të rivlerësimit E. G. dhe P. K.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me nr. 469, datë 01.11.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Ardian Braho.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.04.2024.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*